



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KRYETARI

Nr. 3651 Prot

PROJEKT-VENDIM

Nr. 74 datë 27 . 11 . 2025



PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2026 SË BASHKU ME NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE, DOKUMENTIN PËRFUNDIMTAR TË PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2026-2028

Në zbatim të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nën pikat 1.1 shkronja "b", 1.3 shkronja "c", nenit 41, pika 1, neni 54 shkronja "c", të ligjit ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të projektligjit "Për buxhetin e shtetit për vitin 2026", të nenit 9 të ligjit ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare" të ndryshuar, udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimi nr. 8 datë 28.02.2025 nga Ministria e Financave "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028", nga Ministria e Financave, VKB nr. 10 datë 26.02.2025 "Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave për periudhën 2026-2028", VKB nr. 14 datë 19.03.2025 "Mbi Miratimin e Tavanëve Përgatitor të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028", Udhëzimit i brendshëm nr. 01 datë 02.04.2025 "Për përgatitjen e Buxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028, VKB nr. 31 datë 30.06.2025 "Mbi Miratimin e Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028", VKB nr. 40 datë 18.07.2025 "Mbi miratimin e Tavanëve Përfundimtare të PBA 2026-2028", VKB nr. 59 datë 22.09.2025 "Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm të Rishikuar 2026-2028", VKB "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2026", Tranferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitet 2026-2028 pasqyruar në sistemin e menaxhimit të buxhetit vendor, GMS pasi ka bërë vlerësimin përfundimtar të burimeve dhe kërkesave buxhetore të Programeve për vitin 2026, paraqet materialin në Këshillin Bashkiak dhe,

PROPOZON :

1. Të miratojë Buxhetin Vendor për vitin 2026 dhe dokumentat bazë, si më poshtë :
1.1. Planin e të ardhurave për vitin 2026 në shumën **733,839,281** lekë, detajuar sipas burimeve si më poshtë:

	Në lekë
Të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore	328,632,600
• Të ardhura tatimore	199,744,000
• Të ardhura jo tatimore	125,588,600
• Ardhuratëtjera(gjobat+kuota)	3,300,000
Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar + rritja e nivelit pagave	248,672,249
Të ardhura nga transferta specifike	156,534,432
TOTALI	733,839,281

1.2. Planin e shpenzimeve për vitin 2026, në shumën **733,839,281** lekë, detajuar si më poshtë:

	Në lekë
Shpenzime korrente	529,072,960
Shpenzime kapitale	195,477,321
Fond Rezerve	3,066,000
Fond Kontigjence	3,066,000
Fondi për Mbrojtje civile	3,157,000
TOTALI	733,839,281

2. Të miratojë buxhetin sipas burimeve, shpenzimeve për çdo program sipas klasifikimit ekonomik, funksioneve, projekteve për investime, produkteve dhe njësive shpenzuese për vitin 2026, sipas raporteve përmbledhëse të gjeneruara nga sistemi i menaxhimit të buxhetit vendor nr. BV 1-BV 4, BV 6-BV 15, pjesë përbërëse e projekt-buxhetit.
3. Të miratojë programin përfundimtar buxhetor afatmesëm 2026-2028, sipas raporteve përmbledhëse të gjeneruara nga sistemi i menaxhimit të buxhetit vendor nr. PBA 1- PBA 9, pjesë përbërëse e projekt-buxhetit.
4. Të miratojë listën prioritare të projekteve të investimeve publike, sipas tabelës. pjesë përbërëse e projekt-buxhetit.
5. Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, sipas programeve buxhetore dhe njësive shpenzuese për vitin 2026, me **380** punonjës, sipas raportit përmbledhës të gjeneruar nga sistemi i menaxhimit të buxhetit vendor nr. BV 5, pjesë përbërëse e projekt-buxhetit.
6. Të miratojë shpërblimin e këshilltarëve në Keshillin e Bashkisë në masën 10% të pagës së kryetarit të Bashkisë, në masën 5% të pagës së kryetarit të Bashkisë për kryetarët e fshatrave të Bashkisë, dhe kryetarët e fshatrave të njësive administrative.
7. Të miratojë rritjen e limitit të të ardhurave të Bashkisë Patos për vitin 2026 për diferencat e papërdorura në të ardhura e shpenzime të vitit 2025 sipas shumës së përcaktuar në akt- rakordimin përfundimtar në degën e Thesarit Fier. Ky fond të përdoret për likuidimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të miratuara me buxhetin e vitit 2025 të pafinancuara brenda këtij viti , dhe pjesa e mbetur për objekte të reja

për investim sipas planit të investimeve kapitale dhe prioritare të miratuara në Këshillin Bashkiak ,duke përdorur dhe çdo burim tjetër të ofruar nga donatorë.

➤ Kryetari i Bashkisë në bazë të kompetencave që i jep ligji të kryejë rishpërndarjet si më poshtë:

- Ndërmjet projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program,
 - Ndërmjet produkteve të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program,
 - Rishpërndarjet brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese të cilat miratohen nga nëpunësi autorizues i njësive të qeverisjes vendore nga e cila varet njësia shpenzuese.
- Bashkëlidhur projekt-buxhetit, relacioni me tabelat shoqëruese nga sistemi i menaxhimit të buxhetit vendor .
- Ngarkohet drejtoria e Financës të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2026.

GRUPI I MENAXHIMIT

Ina Sauli	Mimoza Shtëmbari	Juela Shpata	Çajup Refitaj
Ermenita Mici	Alket Halimi	Eneo Xhaferi	Donald Xhafa
Mitjon Nikolla	Arben Shpërdheja	Endrit Çako	Boreta Murati
	Blerina Laçi	Barie Goxhaj	



2026



Mv. 3651/1 ProL

Patos mu 27.11.2025

**BASHKIA
PATOS**

DRAFT BUXHETI I VITIT 2026, PBA 2026-2028

RELACIONI SHOQËRUES

PERMBAJTJA

1.Hyrje.....	fq.1
1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, Buxhetit Vendor si një Instrument efektiv planifikimi në Nivel Vendor.....	fq.1
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË.....	fq.4
2.1 Situata e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore.....	fq.4
2.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e Bashkisë Patos	fq.4
3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË PATOS.....	fq.5
3.1 Strategjia E Zhvillimit Afatgjatw.....	fq.5
4. BUXHETI AFATMESEËM I BASHKISË PATOS 2025-2027.....	fq. 8
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË PATOS NË VITET 2026-2028	
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë PATOS për vitet 2026-2028.....	fq.8
4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë PATOS për periudhën 2026-2028.....	fq.9
4.2 Investimet publike në nivel vendor.....	fq.10
5. BUXHETI I BASHKISË PATOS PËR VITIN 2026.....	fq. 25
II.1 Tranferta nga buxheti i shtetit	fq.45
II.2 Transferta e Pakushtëzuar 2026.....	fq.45
II.3 Transferta per Nivelin e pagave 2026.....	fq.45
II.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale 2026.....	fq.46
II.5 Transferta e kushtëzuar.....	fq. 47
6. PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2026.....	fq. 48
7. PROGRAMET E ZHVILLIMIT TË QYTETIT.....	fq. 54
1.Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	fq. 54
2.Programi Siguria Publike.....	fq. 56
3. Programi Zhvillimi Ekonomik dhe Rural.....	fq. 59
4. Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale.....	fq. 70
5. Programi Punët Publike.....	fq. 80
6. Fondi Rezervë dhe Kontigjencë.....	fq. 85
Lista Prioritare e Objekteve të Investimeve	fq. 87

TABELAT DHE GRAFIKËT

Tabela nr.1 Të ardhurat e bashkisw sipas burimit (sipas tabelave SMBV).....	fq. 8
Tabela nr.2 Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik dhe P.B 2026-2028.....	fq. 9
Tabela nr.3 Tw ardhurat sipas burimeve.....	fq. 25
Tabela nr.4 Tabela e realizimit tw tw ardhurave pwr vitin 2025.....	fq. 27
Tabela nr.5 Transferta pwr nivelin e pagave 2026.....	fq. 43
Tabela nr.6 Transferta e pakushtëzuar sektoriale 2026.....	fq. 44
Tabela nr.7 Shpenzimet e NJVQV sipas programeve tw vitit 2026	fq. 46
Tabela nr.8 Planifikimi i buxhetit 2026 sipas klasifikimit ekonomik	fq. 48
Tabela nr.9 Shpenzime personeli dhe nr. i punonjwsve sipas njwsive shpenzuese tw B.Patos	
fq. 50	
Grafiku nr. 1 Paraqitja grafike e burimeve.....	fq.26
Grafiku nr. 2 Transferta e pakushtwzuar.....	fq.43
Grafiku nr. 3 Grafiku i transfertws sw pagave.....	fq.44
Grafiku nr. 4 Planifikimi i buxhetit 2026 sipas klasifikimit ekonomik.....	fq.48

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetit Vjetor, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i Buxhetit Vjetor 2026 dhe PBA-së 2026-2028, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së 2026-2028, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së dhe Buxhetit Vjetor 2026 planifikimi dhe buxheti vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit

të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njërive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor të vitit 2026 siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimet korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njëria vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxheti Vjetor 2026 përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së dhe Buxhetit vjetor 2026 janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë thelbin e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së dhe Buxhetit 2026 është specifikimi i Treguesve të Performancës specifik, matshëm, arritshëm, rëndësishëm dhe terma kohor (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë.

Një element tjetër i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së dhe buxhetit vjetor 2026 është Hartimi i Kostove të planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë Patos

2.1 Situata e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

Burimi i Informacionit: Plani i Përgjithshëm Vendor.

Buxheti vjetor dhe i vitit 2026-2028 është hartuar duke ju referuar Planit të përgjithshëm Vendor të njesisë tone, si dhe Planit të Investimeve Kapitale.

Buxheti i vitit 2026-2028 është hartuar duke ruajtur traditën e krijuar tashmë dhe duke marrë në konsideratë të gjithë mekanizmat e buxhetimit me pjesëmarrje siç janë, përcaktim i qartë i objektivave sektoriale, vendosje e prioriteteve mbështetur në nevojat dhe kërkesat që vijnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët si dhe mbajtja në nivele optimale e raportit kosto/rezultat duke u mbështetur në kosto reale të ofrimit të shërbimeve.

Zëri i qytetarëve në hartimin e Projekt-Dokumentit të PBA 2026-2028.

Në zbatim të kalendarit u zhvilluan dëgjesa publike me Banorët e njesisë Administrative Zharrëz, me banorët e njesisë Administrative Ruzhdie si dhe në njësinë Administrative Patos. Qytetarët u përfshinë në procesin e këtij dokumenti me mendimet dhe propozimet qytetare në takimet e organizuara të cilat shërbyen si bazë e mirë për hartimin e buxhetit.

Opinionet, propozimet e qytetarëve janë marrë gjatë kontakteve të drejtpërdrejta me ta, dëgjësës publike të zhvilluara në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkia Patos dhe në njësitë Administrative, si dhe nëpërmjet komenteve, kritikave e kërkesave të adresuara pranë administratës së Bashkisë Patos dhe institucioneve të vartësisë të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë në internet.

Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor.

Hartimi dhe mbështetja e zhvillimeve në dokumenta planifikimi gjithëpërfshirës, sjell një frymë të re në menaxhimin e territorit, duke konsideruar jo vetëm tregun mobiluar, por dhe mbështetjen sociale dhe ekonomike të bashkisë, veçanërisht në ato raste kur synohet dhe një frenim apo kthim i trendeve aktuale të braktisjes.

Bashkia e Patosit mbulon në juridiksionin e saj një bashki – Patosin dhe 2 njësi Administrative Zharrëz dhe Ruzhdien dhe ka në perbërjen e saj 1 (një) qytet dhe 18 (tetëmbëdhjetë) fshatra, ku ofrohen shërbimet komunitare.

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë PATOS

Nevojat për ndërhyrje në infrastrukturë dhe shërbime publike.

Problematikat e Sistemit Bujqësor që përfshijnë:

- fragmentimin e tokës bujqësore
- zënien e tokës nga ndërtimet informale
- prania e puseve të naftës dhe ndotja që shkaktohet prej tyre
- mungesa pika grumbullimi, përpunimi etj.
- mungesa në specialist dhe në dije
- organizim i dobët i komunitetit të fermerëve
- nevoja për investime të vazhdueshme në infrastrukturën bujqësore, etj.

Në Sistemin Natyror problematika kryesore qëndron në transformimin e tij në tokë bujqësore duke ndikuar negativisht në ekosistemet territoriale. Pasuritë natyrore, si ujvara e Siqecës etj janë pak të njohura dhe pak të shfrytëzuara.

Problematikat e Sistemit urban mund të përmbledhen:

- Shtrirje e madhe e banesës në territor duke rritur largësinë nga shërbimet.
- Shërbime të grumbulluara në Qytet
- Mungesë e tregjeve ushqimore apo industriale të strukturuar
- Mungesa në qendra komunitare e qendra për grupet vulnerabël të shpërndara në të gjithë Bashkinë.

3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë Patos

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

Ky dokument do të shërbej si një instrument i përpjekjeve vendore për të bërë realitet të prekshëm.

Qëllimi:

Qeverisje vendore e hapur, e drejtë dhe e përgjegjshme ndaj nevojave të komunitetit, sigurimi që të gjithë njerëzit të trajtohen në mënyrë të barabartë, me dinjitet dhe respekt, të lirë nga diskriminimi si parim bazë për ndryshime pozitive, orientim për zhvillimin e ardhshëm bashkëjetesën e industrisë me bujqësinë, duke rritur cilësinë e jetës.

Prioritetet e vitit 2026-2028, vazhdojnë të jenë:

1- Zhvillim Urban

- *Përmirësimi i aksesit rrugor.*
- *Zhvillimi i zonave periferike të qytetit.*
- *Krijimi i hapsirave publike dhe të gjelbëruara në qendër dhe periferi.*

2- Zhvillim Social –Ekonomik

- *Mbështetja e biznesit me politika fiskale për hapjen e vendeve të reja të punës.*
- *Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore.*
- *Mbështetja për krijimin e tregjeve rajonale për shitje.*

3- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi

- *Menaxhimi i mbetjeve urbane*
- *Menaxhimi i gjelbërimit të qytetit*
- *Eliminimi e ndotjes nga ujrat e zeza*
- *Mbështetja për rehabilitimin e shesheve nga facilitetet e abandonuara të industrisë së naftës ndër vite.*

4- Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve

- *Mbështetje për rehabilitimin dhe krijimin e infrastrukturës së ujit*
- *Ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanaleve të ujrave të zeza*
- *Mirëmbajtja urbane*
- *Ndërtim të një tregu bujqësor*
- *Ndërhyrjen në sistemin e kullimit, vaditjes, sistemin e rrugëve të parcelave,*
- *Shtimin e sipërfaqeve të pyjeve nepërmjet mbjelljes së sipërfaqeve të zhveshura*
- *Garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse.*

5- Zhvillimi i Bujqësisë

- Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes
- Mbështetje e biznesit e fermereve për promovimin e produkteve bujqësore e blegtorale të zonës.
- Mbështetja e bashkëpunimit ndërmjet sektorit turistik dhe sektorit bujqësor e blegtoral.
- Paketa fiskale për thithjen e investitorëve të rëndësishëm dhe punëdhënësve të mëdhenj, për zhvillimin e filialeve apo tregjeve bujqësore.

Në zhvillimin e ardhshëm të territorit janë përcaktuar 3 drejtime kryesore të zhvillimit.

- Zhvillimi ekonomik
- Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve
- Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe ambientale.

Këto drejtime përkojnë me disa objektiva strategjike:

A. Zhvillimi ekonomik

Objektivi 1 Një ekonomi e balancuar që krijon vende punë të kualifikuara dhe një mjedis tëpërshtatshëm për zhvillimin e sektorit primar, industrisë dhe shërbimeve.

Objektivi 2 Pushteti vendor bashkëpunues dhe transparent, nxitës i zhvillimit ekonomik me anë të politikave fiskale, nismave, promovimit dhe marketingut.

B. Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve

Objektivi 1 Lagje dhe fshatra që sigurojnë një mjedis të sigurtë, mundësi ndërveprimi social dheshërbime të orientuara drejt mirëqenies së banorëve

Objektivi 2 Sigurimi i një varieteti tipologjish strehimi për të gjitha nivelet e të ardhurave, në të gjithëterritorin, ofrimi i një larmie alternativash në zgjedhjen e mënyrës të jetesës dhe vendbanimit si përgjigje e ndryshimeve demografike.

Objektivi 3 Sigurimi i një rrjeti transporti dhe mobiliteti të sigurtë, të aksesueshëm, të qendrueshëm.

Objektivi 4 Sigurimi i rrjeteve dhe struktura inxhinjerike që sigurojnë një ambient të shëndetshëm duke ulur impaktin mjedisor.

C. Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe Mjedisore

Objektivi 1 Ruajtja dhe rivlerësimi i elementeve të trashigimisë që janë themelet e qytetërimit dhe konfirmojnë të shkuarën.

Objektivi 2 Ruajtja e mjedisit natyror duke e integruar në aspektet argëtuese dhe sportive, me anë të krijimit të aksesit dhe mundësive për argëtim dhe shijim të natyrës.

Objektivi 3 Integrimi i elementëve natyrore dhe kulturor në jetën kulturore dhe artistike të bashkisë për të promovuar më tej territorin.

Bashkia Patos ka respektuar të gjitha kërkesat ligjore për hartimin dhe paraqitjen në Këshillin Bashiak të të gjithë dokumentave strategjikë dhe buxhetor, duke ndjekur të gjitha hapat dhe afatet e përcaktuara në ligj, për të siguruar një proces të plotë buxhetor.

4. BUXHETI AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2026-2028

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Patos gjatë periudhës 2026-2028, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2026-2028, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2026-2028. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia.

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë PATOS në vitet 2026-2028

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë PATOS për vitet 2026-2028

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme. Nuk pati ndryshime në të ardhurat e parashikuara duke mbetur të njëjtat krahasuar me fazën kaluar.

Tabela nr. 1 (sipas tabelave në SMBV). Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

Nr.	EMERTIMI	Viti 2025 Fillestar	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
1	Të ardhurat e vitit	312,582,000	328,632,600	326,632,600	326,632,600
2	Transferta pakushtëzuar	180,535,490	188,943,382	196,500,801	205,028,690
2.0	Transferta rritja e nivelit të pagave	47,536,439	59,728,867	59,728,867	59,728,867
3	Transferta pakushtëzuar sektoriale	136,012,302	156,534,432	156,534,432	156,534,432
3a	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	25,217,848	27,385,297	27,385,297	27,385,297
3b	Ujitje Kullimi	17,295,179	18,329,082	18,329,082	18,329,082
3c	Administrim Pyje	1,213,836	1,252,965	1,252,965	1,252,965
3d	Rrjeti rrugor rural	2,302,138	2,371,911	2,371,911	2,371,911
3e	Menaxhimi i mbetjeve	5,199,667	11,900,000	11,900,000	11,900,000
3f	Arsimi bazë	80,227,424	89,639,341	89,639,341	89,639,341
3g	Arsimi mesëm	4,556,210	5,655,836	5,655,836	5,655,836
	Totali:	676,666,231	733,839,281	739,396,700	747,924,589

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Patos për periudhën 2026-2028

Tabela nr. 2 Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik dhe programeve buxhetore 2026-2028

SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK DHE PROGRAMEVE BUXHETORE 2026-2028								
Emërtimi, kod i programit			Viti 2026					Pesha specifike per cdo program %
			SHUMA	Shpz. Personeli (600,601)	Shpz. Operative (602,606)	Shpz. Mbrojtje civile,tjera(604, 609)	Investime (Shpenzime Kapitale (230, 231)	
1	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	AA112	107,032,429	78,213,258	28,319,171	0	500,000	15
2	Siguria Publike	AB112	61,073,664	52,457,531	5,459,133	3,157,000	0	8
3	Zhvillimi Ekonomik dhe Rural	AC112	188,314,036	34,800,499	14,928,047	0	138,585,490	26
4	Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale	AD112	170,211,210	131,061,611	33,163,768	0	5,985,831	23
5	Punët Publike	AE112	201,075,942	88,348,675	62,321,267	0	50,406,000	27
6	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	AF112	6,132,000	0		6,132,000		1
Totali			733,839,281	384,881,574	144,191,386	9,289,000	195,477,321	100
Pesha specifike per cdo kategori ekonomike %			100	52	20	1	27	100
Emërtimi, kod i programit			Viti 2027					
1	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	AA112	106,660,699	78,213,258	28,447,441	0	0	15
2	Siguria Publike	AB112	61,073,664	52,457,531	5,459,133	3,157,000	0	8
3	Zhvillimi Ekonomik dhe Rural	AC112	198,018,569	34,800,499	14,928,047	0	148,290,023	27
4	Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale	AD112	195,235,826	131,061,611	34,574,608	0	29,599,607	26
5	Punët Publike	AE112	172,275,942	88,348,675	62,321,267	0	21,606,000	23
6	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	AF112	6,132,000	0	0	6,132,000		1
Totali			739,396,700	384,881,574	145,730,496	9,289,000	199,495,630	100
Pesha specifike per cdo kategori ekonomike %			100	52	20	1	27	100

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK DHE PROGRAMEVE BUXHETORE 2026-2028								
Emërtimi, kod programit			Viti 2026					Pesha specifike per cdo program %
			SHUMA	Shpz. Personeli (600,601)	Shpz. Operative (602,606)	Shpz. Mbrojtje civile,tjera(604, 609)	Investime (Shpenzime Kapitale (230, 231)	
Emërtimi, kod programit			2028					
1	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	AA112	107,204,629	78,213,258	28,491,371	0	500,000	14
2	Siguria Publike	AB112	61,073,664	52,457,531	5,459,133	3,157,000	0	8
3	Zhvillimi Ekonomik dhe Rural	AC112	178,852,135	34,800,499	14,928,047	0	129,123,589	24
4	Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale	AD112	217,636,219	131,061,611	34,574,608	0	52,000,000	29
5	Punët Publike	AE112	177,025,942	88,348,675	62,321,267	0	26,356,000	24
6	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	AF112	6,132,000	0	0	6,132,000		1
Totali			747,924,589	384,881,574	145,774,426	9,289,000	207,979,589	100
Pesha specifike për cdo kategori ekonomike %			100	51	19	1	28	100

4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR

FISHAT E PROJEKTEVE PËR BUXHETIN 2026-2028

2026 199,495,630 LEKË

2027 199,495,630 LEKË

2028 207,979,589 LEKË

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
<u>Zhvillimi ekonomik dhe rural</u>	
1. Rikonstruksion i rrugës “Manxhari”, Gjinoqare	Rruga e cila do ti nënshtrohen rikonstruksionit ndodhet në Njësinë Administrative Ruzhdie dhe është rruga kryesore e fshatit Gjinoqarë. Rruga ka një gjatësi prej L=1600m dhe gjerësi b=3.5m dhe është pothuajse totalisht e amortizuar duke vështirësuar qarkullimin e banorëve për kryerjen e aktiviteteve të tyre të përditshme. Prej vitesh nuk janë bërë ndërhyrje në këtë segment pervec shtrimit të saj me rërë

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	bituminoze i cili është një material që nuk siguron jetëgjatësi dhe amortizimi i rrugës deri më sot është kthyer në një problematikë për banorët e zonës. Punimet që përfshin ky projekt: Projekti parashikon ndërhyrje në të gjithë gjatësinë e rrugës “Manxhari” dhe degezimet e saj. Bazuar në karakteristikat e ndërhyrjeve në trupin e rrugës dhe tipin e profilin terthor, segmentet rrugore do të trajtohen si me poshtë: <u>Aksi kryesor i rrugës: Elementët përbërës kryesor të këtij segmenti janë karrexhata, e cila ka një gjërësi asfalti prej 3.5 m ose 350 cm karrexhate në varësi të hapësirës së lejuar urbane dhe fluksit të mjeteve në zonë. Referuar paketës së shtresave rrugore, aksi kryesor dhe degëzimet përkatëse do të pajisen me paketën e shtresave:</u> • Shtrese Cakelli 15 cm • Stabilizant 10 cm • Binder 5 cm • Asfaltobeton 3 cm. Përfituesit nga ky projekt janë: - Banorët e zonës. Vlera totale e Investimit: - Në vitin 2026: 4,500,000 lekë - Në vitin 2027: 4,000,000 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 8,500,000 lekë</u> Kohëzgjatja e Investimit: 2 Vite
2. Rikonstruksion i rrugës “Argjinatura”, Belinë	Rruga e cila do të nënshtrohet rikonstruksionit ndodhet në fshatin Belinë. Aksi kryesor i rrugës ka patur ndërhyrje të pjesshme përgjatë kohës, ku sipërfaqja e rrugës është trajtuar me rërë bituminoze, e cila aktualisht ndodhet në gjendje të amortizuar. L=900 m Punimet që përfshin ky projekt: Projekti parashikon ndërhyrje në të gjithë gjatësinë e aksit kryesor të rrugës “Argjinatura”. Bazuar në karakteristikat e ndërhyrjeve në trupin e rrugës dhe tipin e profilin terthor, segmentet rrugore do të trajtohen si më poshtë: <u>Referuar paketës së shtresave rrugore, aksi kryesor dhe degëzimet përkatëse do të pajisen me paketën e shtresave:</u> • Shtrese Cakelli 15 cm • Stabilizant 10 cm • Binder 5 cm • Asfaltobeton 3 cm. Përfituesit nga ky projekt janë:

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	- Banorët e zonës. Vlera totale e Investimit: - Në vitin 2026: 4,400,000 lekë - Në vitin 2027: 4,000,000 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 8,400,000 lekë</u> Kohëzgjatja e Investimit: 2 Vite
3. Përmirësimi i Banesave ekzistuese për familjet në nevojë (Bashkëfinancim)	Në kuadër të aplikimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me objekt “Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese, për familje” bashkia Patos ka aplikuar në këtë program për përmirësimin e kushteve të 20 familjeve të cilat kanë plotësuar kushtet sipas ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar. Përmes ndërhyrjeve të planifikuara, projekti do të kontribuojë në sigurimin e kushteve minimale të jetesës, duke përmirësuar cilësinë e jetës për familjet përfituese dhe duke reduktuar ndjeshëm pabarazitë sociale në komunitet. Vlera totale e projektit është: 13,637,105.80 lekë Bashkëfinancim 30%: 4,091,131.74 lekë Përfituesit nga ky projekt janë: - 20 Familje. Vlera totale e Investimit - Në vitin 2025: 800,000 lekë - Në vitin 2026: 3,291,132 lekë Kohëzgjatja e Investimit: 2 Vit
4. Rikonstruksion i bllokut përpara pallatit të Kulturës	Objekti ndodhet në Lagjen “Naftëtari”, në zonën përpara Pallatit të Kulturës. Ky bllok banimi kufizohet në pjesën jugore nga Shëtitorja “Republika”, në pjesën veriore nga rruga “Demokracia”, në lindje nga rruga “Heronjtë e Linasit” dhe në perendim nga rruga “Sulo Goxhaj”. Për shkak të mungesës së ndërhyrjeve, hapësirat rreth pallateve janë të pasistemuara, ka ndodhur zaptim i hapësirave publike me ndërtime informale, sistemi i kanalizimeve të ujrave të zeza ekziston pjesërisht por në gjendje të amorizuar dhe pa kapacitetin e mjaftueshëm për të grumbulluar dhe kanalizuar gjithë shkarkimet në zone, rrjeti i ndricimit mungon plotësisht, mungojnë hapësirat e gjelbëruara dhe sistemuara për banorët, lulishte apo kënde lojrash për fëmijë, hapësirat për parkim si dhe rrjeti i rrugëve të brendshme ka nevojë për rikonstruksion pasi është i amortizuar dhe krijon vështirësi në qarkullimin e banorëve dhe mjeteve. Punimet që përfshin ky projekt: Për ndërhyrje të strukturuar projekti do të trajtojë 4 zona/ miniblloqe kryesore dhe rrugët “Thimi Sinjari” dhe “Ahmet Bajo”.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	Sip (Zona 1) = 1435 m² ; Sip (Zona 2) = 2385 m² ; Sip (Zona 3) = 2055 m² ; Sip (Zona 4) = 878 m² ; Në këto zona projekti parashikon sistemimin e hapësirave perimetrale të godinave, ndërtim rrugica e trotuare me pllaka, krijimin e hapësirave të gjelbëruara dhe të konturuara, vendosje stola pushimi, kosha të mbetjeve, ndërtim i shkallëve komunikuese në zonat me disnivel të kuotave, vendosje të elementeve të ndricimit dhe krijimi i posteve të parkimit. <i>Rruga "Ahmet Bajo"</i> me gjatësi rreth 225 ml. Gjerësia e karrexhatës së rrugës së rikonstruktuar do të jetë 3.0 m - 3.30 m. <i>Rruga "Thimi Sinjari"</i> me gjatësi 308 ml. Gjerësia e karrexhatës është 3.50 m – 4.0 m. Përfituesit nga ky projekt janë: - Banorët e zonës dhe biznese që ushtrojnë aktivitetin në këtë zonë. Vlera e parashikuar për këtë projekt është : -Në 2025: 47,337,658 lekë -Në 2026: 967,234 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 48,304,892 lekë</u> Kohëzgjatja e Investimit: 2 Vite
5. Rikonstruksion i blloqeve të banimit në lagjen "1 Maj"	Objekti ndodhet në lagjen "1 Maj", Patos dhe kufizohet nga segmentet e rrugëve kryesore "Unaza", "7 Marsi" dhe "Koli Marku". Blloku ka një sipërfaqe prej rreth 68,450m² dhe sipërfaqja në të cilën do të ndërhyhet është ndarë në 4 zona secila me një sipërfaqe prej: Sip(zona A)=21,338 m²; Sip(zona B)=13,314 m²; Sip(zona C)= 19,320m²; Sip(zona D)=8,931 m²; Infrastruktura rrugore, kryesisht rrugët e brendshme, kalimet e këmbësorëve mungojnë totalisht në zonë, duke përbërë një rrezik për banorët e lagjës. Aksesueshmëria brenda për brenda bllokut është e vështirë sidomos përgjatë ditëve me reshje të denduara ku mungesa e kanalizimeve përbën një pengesë të madhe për kalimin e mjeteve dhe lëvizjen e banorëve. Punimet që përfshin ky projekt: 1. Rehabilitimin e zonës me të gjithë elementët e nevojshëm infrastrukturorë. 2. Parashikimin e kalimeve për këmbësorët me të gjitha shtresat përkatëse dhe të konturuara me bodura të parafabrikuara. 3. Në pjesët e ndërprerjes së trotuarëve do të parashikohet ndërtimi i panduseve të kalimit në nivel rrugë – trotuar për personat me aftësi të kufizuar. 4. Përcaktimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	5. Do të realizohet ndriçimi i zonës sipas parametrave dhe standardeve në fuqi. 6. Sistemimi i ujrave të bardha dhe të zeza. Përfituesit nga ky projekt janë: - Rreth 4000 banorë dhe biznese që ushtrojnë aktivitetin në këtë zonë. Vlera e parashikuar për këtë projekt është : -Në 2025: 16,904,000 lekë -Në 2026: 80,000,838 lekë -Në 2027: 124,600,000 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 221,504,838 lekë</u> Kohëzgjatja e Investimit: 3 Vite
6. Rikonstruksion i kopshtit nr. 2	Objekti aktualisht frekuentohet nga rreth 50 fëmijë të grupmoshave të ndryshme dhe kushtet në të cilat ato qëndrojnë nuk plotësojnë as kërkesat minimale optimale për zhvillimin e mësimdhënies. Në pamje të parë vihet re fasada e amortizuar, mungesa e sistemimit të hapësirave dhe oborrit përreth, amortizimi i dyerve dhe dritareve të jashtme si dhe shumicës së elementeve të tjerë të brendshëm të objektit. Disa nga problematikat kryesore kanë të bëjnë me dëmtimin e suvatimeve të jashtme, mos shfrytëzimi i të gjitha ambjenteve për shkak të amortizimit të tyre qoftë jashtë ose brenda. Lagështia është një tjetër faktor e cila ka ndikuar dhe në uljen e frekuentimit nga fëmijët për shkak dhe të problematikave shëndetësore që sjell. Gjithashtu vihet re mungesa e sistemit në ngrohje-ventilimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit. Të dhënat teknike: Kati pare: Sip=160m² Kati dytë: Sip=160m² Punimet që përfshin ky projekt: Projekti parashikon ndërhyrjen në të gjithë kompleksitetin e godinës. Janë parashikuar ndërhyrje në disa kategori punimesh pa ndryshuar strukture dhe funksionin. Ky rikonstruksion do të jetë në fasadë dhe i brendshëm. Do të ketë një riorganizim të hapësirave dhe dhomave. Përfituesit nga ky projekt janë: - Bashkia Patos Vlera e parashikuar për këtë projekt është : -Në 2026: 247,318 lekë -Në 2027: 5,000,000 lekë -Në 2028: 45,000,000 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 50,247,318 lekë</u> Kohëzgjatja e Investimit: 3 Vite

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
7. Rikonstruksion i rrugës “Rilindja”, Belinë	Segmenti rrugor “Rilindja”, i cili ka nevojë për ndërhyrje ndodhet në fshatin Belinë dhe është aksi kryesor i cili e lidh këtë fshat me qytetin e Patosit, Fierit dhe qendrën e Njësisë Zharrëz. Për shkak të mungesës së ndërhyrjeve për një kohë të gjatë, segmenti i kësaj rrugë me gjatësi rreth 1000 ml ndodhet në gjendje tejte të amortizuar, ku çarjet e trupit të rrugës vazhdojnë të avancojnë. Segmenti me nevojë urgjente për ndërhyrje shtrihet në distancë rreth 200 m përpara urës së Belines dhe rreth 800 m pas urës, në drejtim të qytetit të Fierit. Amortizimi i këtij aksi është bërë problem për qarkullimin e banorëve të zonës, fermerëve, aktivitetet tregëtare si dhe burim aksidentesh vecanërisht gjatë natës ku mungesa e ndricimit rrugor rrit rrezikshmërinë qarkullimit në këtë rrugë. Punimet që përfshin ky projekt: Projekti parashikon ndërhyrjen në një segment me gjatësi rreth 1000 ml të rrugës Rilindja. Gjerësia mesatare e rrugës ekzistuese është 5.5m. Ndërhyrjet konsistojnë në skarifikimin e shtresës ekzistuese asfaltike me makineri përgjatë gjithë gjatësisë dhe më pas gërmimin e nënshtresave të rrugës deri në një thellësi prej 50-60cm. Pas gërmimit të sipërfaqes rrugore në një gjerësi prej 700 cm dhe thellësi 50-60 cm, do të bëhet cilindrimi i kasonetes me rrul me qëllim krijimin e një sipërfaqe uniforme dhe kompakte. Bazamenti i rrugës do të trajtohet me një shtresë gjeotekstili me gramaturë 180g/m². Shtresa e gjeotekstilit do të vendoset mbi kasonetën e cilindruar dhe do të lihet jashtë kasonetës në një gjatësi rreth 1.5 m në secilin kah, të mjaftueshme për t’u palosur deri nën shtresën e stabilizantit. Mbi gjeotekstil do të hidhet një shtresë zhavor lumi me trashësi 20 cm dhe do të bëhet cilindrimi i saj. Mbi shtresën e cilindruar të zhavorit do të procedohet me hedhjen e paketës së shtresave rrugore si më poshtë: 1. Shtresë cakëlli mbeturine kave t=20 cm 2. Shtresë stabilizanti t=10 cm 3. Shtresë binderi me granil gur kave t=6cm 4. Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave t=4 cm Përfituesit nga ky projekt janë: - Banorët dhe bizneset që ushtrojnë aktivitetin në këtë zonë. Vlera e parashikuar për këtë projekt është : -Në 2026: 7,000,000 lekë -Në 2027: 5,554,637 lekë -Në 2028: 42,554,363 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 55,109,000 lekë</u> Kohëzgjatja e Investimit: 3 Vite

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
8. Krijimi i Parkut Rekreativ në Lagjen e Re	Objekti në fjalë që do të merret në studim ndodhet në lagjen “e Re”, Patos dhe përbëhet nga 2 zona, përkatësisht zona A dhe Zona B. Zona A kufizohet nga segmentet e rrugëve “Sali Alushi” dhe rruga e “Vreshtit”. Zona B shtrihet përgjatë 2 rrugëve “Qerim Gropa” dhe rruga e “Vreshtit”. Secila nga zonat nga sipërfaqet si më poshtë: <i>Të dhëna teknike:</i> $Sip_{(zona A)}=1900\text{ m}^2$; $Sip_{(zona B)}=15,750\text{ m}^2$; Në këtë zonë jetojnë rreth 4228 banorë, të cilët përballen vazhdimisht me mungesën e infrastrukturës dhe hapësirave rekreative. Në të gjithë lagjen mungojnë ambiente për fëmijë të cilët mund ti frekuentojnë në kohën e lirë. Infrastruktura rrugore, kryesisht rrugët e brendshme, kalimet e këmbësorëve i janë nënshtruar rehabilitimit total së fundmi duke ofruar banorëve aksesin e munguar prej vitesh. Në këtë lagje është ndërhur duke rehabilituar kanalizimet e ujërave të zeza dhe të bardha, sistemin rrugor dhe trotualet. Gjithashtu rruga është paisur me ndriçim dhe pjesërisht hapësira të gjelbëruara. Problematikë për të gjithë grupmoshat që frekuentojnë dhe jetojnë në këtë lagje është mungesa e hapësirave rekrative. Punimet që përfshin ky projekt: 1. Ndërtimin e një fushe basketbolli në zonën A. 2. Në zonën B të realizohet një kompozim i cili kombinon aktivitete të ndryshme, lojëra në natyrë, zona me gjelbërim, pistë biçikletash, kënde lojrash etj. Përfituesit nga ky projekt janë: Rreth 4228 banorë dhe biznese që ushtrojnë aktivitetin në këtë zonë. Vlera e parashikuar për këtë projekt është : -Në 2026: 300,000 lekë -Në 2027: 1,000,000 lekë -Në 2028: 5,000,000 lekë Vlera totale e Investimit: 6,300,000 lekë Kohëzgjatja e Investimit: 3 Vite
9. Rikonstruksion i rrugës “Kripallarët” dhe degëzimeve të saj	Rruga e cila do ti nënshtrohet rikonstruksionit ndodhet në zonën Dukas-Kripallarë. Hyrja e këtij segment rrugor ndodhet rreth 200 m nga rruga “Unaza. Gjatësia totale e rrugës duke përfshirë degëzimet shkon 2277 m ose 2.277 km. Aksi kryesor i rrugës ka patur ndërhyrje të pjesshme përgjatë kohës, ku sipërfaqja e rrugës është trajtuar me rërë bituminoze, e cila aktualisht ndodhet në gjendje të amortizuar. Është ndërtuar rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe janë vendosur shtyllat e ndricimit. Punimet që përfshin ky projekt: Projekti parashikon ndërhyrje në të gjithë gjatësinë e aksit kryesor të rrugës “Kripallarët” dhe degëzimet e saj. Bazuar në karakteristikat e

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	nderhyrjeve ne trupin e rruges dhe tipin e profilin terthor, segmentet rrugore do te trajtohen si me poshte: Aksi kryesor i rruges: Karrexhata e rruges do te ketë gjerësi asfalti 400 cm ose 4 m. Në segmentin nga progresiva 0+000 deri në 0+420 karrexhata do të jetë me pjerresi te njëanshme në kahun e kanalit ekzistues betoni per grumbullimin e ujrave te bardha. Gjithashtu në zonat e kthesave karrexhata do të ketë zgjerim dhe pjerrësi të njëanshme për efekt inertësie. Ndërkohë në pjesët e tjera të rrugës, pjerrësia do të diktohet edhe nga kushtet e terrenit, sipas specifikimeve të profilave tërthor. Degezimet: Akset 2-7 janë trajtuar me gjerësi karrexhate në varësi të hapësirës së lejuar urbane dhe fluksit të mjeteve në zonë. Në bazë të këtij vlerësimi, akset (degëzimet) do të kenë gjerësi karrexhate 2 deri në 3m, me pjerresi të varësi të kushteve të terrenit. <u>Referuar paketës së shtresave rrugore, aksi kryesor dhe degëzimet përkatëse do të pajisen me paketën e shtresave:</u> • Shtrese Cakelli 15 cm • Stabilizant 10 cm • Binder 5 cm • Asfaltobeton 3 cm. Përfituesit nga ky projekt janë: - Banorët e zonës. Vlera e parashikuar për këtë projekt është : -Në 2025: 22,382,582 lekë -Në 2026: 27,617,418 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 50,000,000 lekë</u> Kohëzgjatja e Investimit: 2 Vite
10. Përmirësimi i paketës së shtresave asfaltive në rrugën " Heronjtë e Linasit,Shpiragu, Degëzim i rrugës Sulo Goxhaj	Rruga "Heronjtë e Linasit", Patos Rruga ndodhet në Patos dhe është një ndër rrugët kryesore të qytetit. Ajo mundëson kalimin nga rruga "Republika" për në rrugën "Unaza" të cilat janë dy rrugë kryesore të qytetit. Rruga ka një gjatësi L=425m, b=5.20 m. Punimet për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e zonës fillimisht janë kryer nga Agjencia e Shërbimeve e cila ka realizuar sistemimin e trotuarit përgjatë gjithë gjatësisë së rrugës. Ndërhyrja në këtë rrugë parashikon rikonstrukcionin e paketës së shtresave rrugore, ku fillimisht do të realizohet skarifikimi i shtresave ekzistuese të binderit dhe asfaltobetonit, pastrimi dhe sistemi i zonës përreth dhe me pas realizimi i punimeve sipas shtresave përkatëse të përcaktuara në projekt.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	Segmenti i rrugës do të pajiset me paketen e shtresave: Binder t=5 cm, Asfaltobeton t=4cm Degëzimi i rrugës “Sulo Goxhaj”, lagjja “Naftëtari” Rruga ndodhet në lagjen “Naftëtari” e cila aktualisht po i nënshtrohet rikonstruksionit në pjesën me të madhe të saj nga zbatimi i projektit për “Rikonstruksion i bllokut përpara pallatit të kulturës” po ashtu me financimin e FSHZH është rehabilituar e gjithë fasada e pallatit. Aktualisht sheshi para pallatit është në gjendje të keqe, pasi është ndërhur duke liruar të gjitha hapësirat e zëna dhe i gjithë sheshi ka nevojë për sistemim. Ndërhyrja në këtë zonë parashikon rikonstruksionin e paketës së shtresave rrugore në një sipërfaqe prej 1300 m². Do të realizohet pastrimi i zonës dhe rehabilitimi sipas projektit duke parashikuar të gjitha shërbimet e munguara të banorëve. Segmenti i rrugës do të pajiset me paketën e shtresave: Binder t=5 cm, asfaltobeton t=3 cm. Rruga “Shpiragu”, Lagjja e “Re” Rruga ndodhet në lagjen e Re dhe ka gjatësinë prej L=110m, b=3.50m. Gjendja aktuale e kësaj rruge është në kushte jo të mira për arsye se në këtë segment nuk janë bërë ndërhyrje prej vitesh duke sjellë degradimin total të shtresave rrugore. Kryesisht kjo rrugë u shërben banorëve të zonës për qarkullimin dhe lidhjen me pjesë të tjera të zonës për kryerjen e veprimtarive të përditshme. Ndërhyrja në këtë rrugë parashikon rikonstruksionin e paketës së shtresave rrugore në një gjatësi prej 110 m. Do të realizohet skarifikimi i shtresës ekzistuese, pastrimi dhe sistemi i zonës përreth dhe më pas realizimi i punimeve sipas shtresave përkatëse të përcaktuara në projekt. Segmenti i rrugës do të pajiset me paketen e shtresave: Cakëll t=15cm, stabilizant t=10cm, Binder t=5 cm, asfaltobeton t=3cm. Përfituesit nga ky projekt janë: - Banorët e zonës. Vlera e parashikuar për këtë projekt është : -Në 2025: 7,700,000 lekë -Në 2026: 9,900,000 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 17,600,000 lekë</u> Kohëzgjatja e Investimit: 2 Vite
11. Rikonstruksion i shkollës “Sotir Capo” dhe ndërtimi i palestrës	Ky objekt është me funksion shërbim dhe ndodhet në territorin e Njesisë Administrative Zharrëz, Bashkia Patos. Objekti kufizohet në krah të majtë me rrugën nacionale “Fier-Berat” dhe përballë me godinën e Njesisë Administrative Zharrëz. Shkolla ka një frekuentim prej rreth 220 nxënës të cilët zhvillojnë mësimin në 20 klasa të cilët përballen cdo ditë me mungesën e infrastrukturës minimale të

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	nevojshme për mësimdhënie. Aktualisht godina është në gjendje totalisht të rënduar si nga ana funksionale ashtu dhe infrastrukturore. Në objekt mungojnë salla ku mësimi të zhvillohet brenda parametrave normalë ku të jëtë ndriimi i duhur, sistemi i ngrohjes, kabinetet për zhvillimin e lëndëve të ndryshme të cilët kanë të domosdoshme demonstrime faktike. Përgjatë gjithë objektit dallojmë plasaritje të suvatimeve, lagështi, dyer dritare jo funksionale, tualete ne kushte shumë të këqija dhe disa prej tyre aspak funksionale. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri, sistemi i alarmit në rast emergjence mungojnë totalisht. Ndricimi në disa salla është i ulët ose pothuajse fare. Punimet që përfshin ky projekt: Hidroiziolimi i taracës Punime suvatimi dhe lyerje Shtresa pllaka Ndërtimi i palestrës Sistemi i kondicionimit Sistemim i jashtëm etj Përfituesit nga ky projekt janë: - 220 nxënës , Banorët e zonës Vlera e projektit 192,664,044 lekë, 85% MA Vlera e parashikuar për bashkëfinancim 15% nga burimet tona, për këtë projekt është 28,899,607, dhe mbikqyrje kolaudim 2,047,381: Në 2025: 5,800,000 lekë Në 2026: 2,047,381 lekë Në 2027: 23,099,607 lekë Kohëzgjatja: 3 vite
12. Rikualifikim urban sheshi para ish bashkisë	Ky projekt ka për qëllim rikualifikimin e një ndër shesheve kryesore të qytetit me një sipërfaqe prej 1000 m² me qëllim krijimin e një infrastrukture bashkëkohore për banorët e qytetit të Patosit. Projekti synon rehabilitimin e sheshit me të gjithë mobilimin e nevojshëm urban duke krijuar ambiente rekreative dhe çlodhëse për të gjithë banorët e qytetit të Patosit. Përfituesit nga ky projekt janë: -Të gjithë banorët e bashkisë Patos Vlera e parashikuar për këtë projekt është: -Në vitin 2026: 500,000 lekë -Në vitin 2027: 5,000,000 lekë -Në vitin 2028: 78,799,516 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 84,299,516 lekë</u> Kohëzgjatja: 3 vite

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
13. Ndërtim kuartalli të ri të varrezave	Situata aktuale e varrezave në qytetin e Patosit është problematike për shkak të mungesës së hapësirës së nevojshme të dedikuar për varreza. Kjo problematike është menduar të zgjidhet nëpërmjet zgjerimit të sipërfaqes së varrezave ekzistuese të qytetit nëpërmjet shtimit të një kuartalli të ri. Projekti konstaton në përshtatjen e njëparcele prej rreth 1000m² për varreza me të gjithë elementët e nevojshëm. Përfituesit nga ky projekt janë: -Të gjithë banorët e bashkisë Patos Vlera e parashikuar për këtë projekt është: -Në vitin 2026: 200,000 lekë -Në vitin 2027: 2,000,000 lekë -Në vitin 2028: 2,000,000 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 4,200,000 lekë</u> Kohëzgjatja: 3 vite
14. Rikonstruksion i aneksit të stadiumit Patos	Me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për stërvitjen e grupmoshave të ndryshme do të rikonstruktohet fusha e cila ndodhet në krah të stadiumit “Alush Noga” e cila ka një sipërfaqe prej 6,560 m². Fusha do të paisjet sipas parametrave bashkëkohore duke shërbyer fëmijëve dhe të rriturve për aktivitete të ndryshme sportive. Do të parashikohet shtrimi i fushës me shtresat përkatëse, rrethimi, ndriçimi dhe të gjithë elementët e nevojshëm arkitektonik. Përfituesit nga ky projekt janë: -Të gjithë banorët e bashkisë Patos Vlera e parashikuar për këtë projekt është: -Në vitin 2026: 100,000 lekë -Në vitin 2027: 500,000 lekë -Në vitin 2028: 2,000,000 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 2,600,000 lekë</u> Kohëzgjatja: 3 vite
15. Rikonstruksion i rrugës “Kararaj”, Ruzhdie	Rruga e cila do të nënshtrohen rikonstruksionit ndodhet në Njësinë Administrative Ruzhdie. Rruga ka një gjatësi prej L=520m dhe gjerësi b=3.5m dhe është pothuajse totalisht e amortizuar duke vështirësuar qarkullimin e banorëve për kryerjen e aktiveve të tyre të përditshme. Prej vitesh nuk janë bërë ndërhyrje në këtë segment përveç shtrimit të saj me rërë bituminoze i cili është një material që nuk siguron jetëgjatësi dhe amortizimi i rrugës deri më sot është kthyer në një problematikë për banorët e zonës. Përfituesit nga ky projekt janë:

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	-Të gjithë banorët e Njesisë Ruzhdie Vlera e parashikuar për këtë projekt është: -Në vitin 2026: 100,000 lekë -Në vitin 2027: 4,135,386 lekë -Në vitin 2028: 4,769,710 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 9,005,096 lekë</u> Kohëzgjatja: 3 vite
Projektet(me blerje):	Ndërhyrjet dhe problematikat:
Blerje skrepi për pastrim të kanaleve kulluese dhe vaditëse	Ky investim do të kryhet në blerjen e një mjeti që do të shërbej për pastrimin e kanaleve kullues, prerjen e ferrave, hapjen e gropave i cili do të përdoret në varësi të nevojave prioritare që do të lindin në kanalet vaditëse apo kulluese në 3 njësitë administrative të Bashkisë Patos për eliminimin e problematikave të mundshme lidhur me bimësinë. Punimet do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike sipas udhëzimeve nga Sektori i Ujitjes dhe kullimit dhe Bujqësisë. Përfituesit nga ky objekt janë: -Të gjithë fermerët në zonat rurale Vlera totale e parashikuar për këtë mjet: 2,000,000 lekë me financim si më poshtë: -Në 2026: 2,000,000 lekë Kohëzgjatja e Investimit: 1-Vit.
Mure mbajtëse në qytet dhe rrethina (Blerje bazë materiale)	Ky investim konsiston në blerjen e bazës materiale të nevojshme për ndërtimin e mureve mbajtëse të parashikuar në zonat: - Mur mbjatës përgjatë rrugës Ymeraj, fshati Gjynoqarë - Mur mbajtës në lagjen 29 Marsi Objektivi i këtij investimi është sistemimi dhe sigurim i stabilitetit të dherave duke shmangur problematikën e rrëshqitjeve. Punimet do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike sipas udhëzimeve nga Sektori i Monitorimit të Investimeve dhe Shërbimeve. Përfituesit nga ky objekt janë: -Rreth 1000 banorë të zonave përkatëse Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 500,000 lekë me financim si më poshtë: -Në 2026: 500,000 lekë Kohëzgjatja e Investimit: 1-Vit.
Ndërtim kuz dhe kub (Bazë materiale)	Konsiston në blerje bazë materiale për sistemimin e rrjetit të ujërave të bardha dhe të zeza në disa zona në qytet tubo të brinjëzuara të diametrave të ndryshëm, ndërtimi i pusetave të kontrollit sipas

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	udhëzimeve nga Sektori i Monitorimit të Investimeve dhe Shërbimeve. Objektivi i këtij investimi është përmirësimi i infrastruktures nëntokësore duke përmirësuar dhe eliminuar ndotjen mjedisore. Punimet do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike sipas udhëzimeve nga Sektori i Monitorimit të Investimeve dhe Shërbimeve. Sistemi i kanalit të ujërave të zeza është parashikuar kryesisht në fshatin Dukas Çoban, lagjja e Mustafa Matohiti, fshati Rrerës. Sistemimi i kanalit të ujërave të bardha është parashikuar Përfituesit nga ky projekt janë: -Banorët në zonat e ndërhyrjeve. Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 2,800,000 lekë me financim si më poshtë: -Në 2026: 1,000,000 lekë -Në 2027: 1,000,000 lekë -Në 2028: 900,000 lekë Kohëzgjatja e Investimit: 3-Vite.
Kontenierë për 3 njësitë	Konsiston në blerje bazë materiale për kontenierë plastikë referuar specifikimeve teknike. Do të bëhet zëvendësimi i kontenierëve të dalë jashtë përdorimit, si dhe pajisja me kontenierë të rinj në zona të reja. Përfituesit nga ky projekt janë: -Gjithë banorët e qytetit Patos që përfitojnë këtë shërbim. Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 18,068,000 lekë me financim si më poshtë: -Në 2026: 4,756,000 lekë -Në 2027: 6,656,000 lekë -Në 2028: 6,656,000 lekë Kohëzgjatja e Projektit: 3 vjet
Blerje asfalto-beton për shtrim rrugësh	Ky investim konsiston në blerjen e bazës materiale për shtrimin e segmenteve rrugore me material mbushës (inerte) dhe shtresat asfaltike (binder dhe tapet) për përmirësimin dhe lehtësimin në aksesimin e banorëve të qytetit të Patosit dhe njësive administrative. Punimet kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike sipas udhëzimeve nga Sektori i Monitorimit të Investimeve dhe Shërbimeve. Ndërhyrjet konsistojnë në nënshtresat rrugore si: çakëll 10-15 cm (në varësi të gjendjes ekzistuese të rrugës), stabiliznat 10 cm, binder 5cm dhe asfaltobeton 3 cm. Përfituesit nga ky projekt janë: Gjithë banorët e qytetit Patos dhe Njësive Administrative

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 30,000,000 lekë me financim si më poshtë: -Në 2026: 30,000,000 lekë Kohëzgjatja e Investimit: 1-Vit.
Blerje pemë dekorative	Ky investim eshte parashikuar për blerjen e bazës materiale si: pemë dekorative për shtimin e zonave të gjelbëruara në qytet dhe njësitë administrative si dhe zëvendësimin e pemëve të dëmtuara nga sezoni i dimrit. Punimet do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike. Përfituesit nga ky projekt janë: -Gjithë banorët e Bashkisë Patos Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 1,200,000 lekë me financim si më poshtë: -Në 2026: 600,000 lekë -Në 2027: 600,000 lekë Kohëzgjatja e Projektit: 2 Vite.
Ndriçim rrugor (Bazë materiale)	Ky projekt parashikon investime në shtim të ndriçimit në ato segmente që janë në errësirë. Në zonat rurale ku edhe furnizimi me energji elektrike është i vështirë dhe me kosto, është parashikuar të instalohen impiante autonome me panele fotovoltaike. Prioritet u është dhënë rrugëve të njësisë Zharrëz dhe Ruzhdie si dhe disa segmenteve brenda qytetit të Patosit. Shtimi i rrjetit të ndriçimit në segmentet rrugore: “Demollaj” Zharrëz, “Halit Gjeriti” Zharrëz, “Ymeraj” Gjynaqarë, “Manxharaj” Gjynaqarë, Dukas Çoban, Lagja e Re (përgjatë përroit) etj. Përfituesit nga ky projekt janë: -Gjithë banorët e qytetit Patos dhe Njësive Administrative Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 38,300,000 lekë me financim si më poshtë: -Në 2026: 12,600,000 lekë -Në 2027: 10,100,000 lekë -Në 2028: 15,600,000 lekë Kohëzgjatja e Investimit: 3 vite.
Ndërti të trotuarëve dhe shesheve të pallateve (Blerje bazë materiale)	Ky investim për blerje të bazës materiale do të përdoret për ndërhyrjet që do të bëhen kryesisht në rrugët e ndërtuara me asfaltobeton sipas marrëveshjes kuadër që është zbatuar për shtrimin e disa rrugëve të brendshme në Njësitë Administrative Zharrëz dhe Ruzhdie si dhe në disa zona periferike të Bashkisë Patos.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	Projekti ka parashikuar ndërtimin e trotuarëve përgjatë rrugës për t'i shërbyer banorëve të zonës. Ndërtimi i trotuarëve do të bëhet sipas strukturës dhe terrenit që krijon mundësinë për ndërtimin e tyre, pra trotuarët do të variojnë me gjerësi nga 1.5-2,5m. Realizimi i trotuarëve do të bëhet me pllaka betoni dhe do të ketë prani të pemëve dekorative. Përgjatë gjatësisë së tyre do të mundësohet dhe ndriçim dhe në disa rrugë qëndore do të realizohen trotuare në të dy krahët. Vlera e parashikuar për këtë investim: 1,700,000 lekë me financim si më poshtë: -Në 2026: 700,000 lekë -Në 2027: 500,000 lekë -Në 2028: 500,000 lekë Kohëzgjatja e Investimit: 3 vite
• Stola për lulishtet e qytetit dhe rrethina	Konsiston në blejren e stolave në lulishtet e qytetit dhe zonat periferike të qytetit si dhe zëvendësimi i stolave të dëmtuar. Modeli i stolave duhet të jetë sipas përcaktimeve në projekt duke iu përshtatur modelit të stolave ekzistues. Përfituesit nga ky projekt janë: Gjithë banorët përdorues të lulishteve Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 500,000 lekë me financim si më poshtë: Në 2026: 500,000 lekë Kohëzgjatja e Projektit: 1-Vit
• Ndërtim kabinë me parametra 20kV	Synimi i këtij projekti është ndërtimi i një kabinë tip box pasi pajisjet mbrojtëse janë jashtë funksionit dhe nuk sigurojnë mbrojtje të mjaftueshme ndaj rreziqeve elektrike duke marrë parasysh amortizimin e kabinës ekzistuese. Ky projekt ka për qëllim zëvendësimin e transformatorit, çelave të linjës dhe të transmetimit, ndarjen e ambienteve të rrjetit metalike si dhe furnizimi me energji elektrike duke bërë lidhjen me linjën 6 dhe/ose 20kV Punimet që përfshin projekti janë si më poshtë: -Ndërtimi i bazamentit për vendosjen e kabinës tip box; -Vendosja e kabinës tip box; -Vendosja e transformatorit; -Ndarja me rrjetë metalike; -Lidhja me linjën 6 kV dhe/ose 20 kV Përfituesit nga ky projekt janë: -Institucioni i Bashkisë Patos

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
	Vlera totale e parashikuar për këtë projekt: 2,500,000 lekë me financim si më poshtë: -Në vitin 2026: 500,000 lekë -Në vitin 2027: 2,000,000 leke Brenda vlerës së projektit përfshihet edhe vlera e mbikqyrësit dhe kolaudatorit. Kohëzgjatja e Projektit: 2-Vite.

5.BUXHETI I BASHKISË PATOS PËR VITIN 2026

Hartimi i Buxhetit për vitin 2026, vijon në rrugën e nisur të të qënës pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm, me një përfshirje të të gjitha institucioneve të vartësisë së Bashkisë në këtë proces. Bashkia Patos ka respektuar të gjitha kërkesat ligjore për hartimin dhe paraqitjen në Këshillin Bashiak të të gjithë dokumentave strategjikë dhe buxhetorë, duke ndjekur të gjitha hapat dhe afatet e përcaktuara në ligj, për të siguruar një proces të plotë buxhetor.

Buxheti i vitit 2026 do të ketë në konsideratë:

- Reflektimin e politikave fiskale të aplikuara gjatë vitit 2026 dhe ndikimin e tyre në përmbushjen e objektivave,
- Alokimin e të ardhurave për vitet në vazhdim,
- Prioritizimin e shpenzimeve kapitale sipas programeve të zhvillimit të qytetit,
- Realizimin e shpenzimeve për përmbushjen e funksioneve.
- **Metodologjia e Re**

Bashkia Patos është pjesë e metodologjisë së re dhe ka parashikuar zbatimin e buxhetit në pesë programe buxhetore si dhe programi i rezervës dhe kontigjencës, i cili është hartuar më vete. Buxheti total i Bashkisë Patos menaxhohet sipas 5 programeve të shpenzimeve të cilat lidhen me performancën për secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë. Programet buxhetore janë sipas standerdeve të përcaktuara në Udhëzimin 23/2018 të ndryshuar, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Udhëzimin 6/2023 për Bashkitë pilot. Përgatitja e PBA-së 2026-2028 si edhe Buxheti 2026 janë përgatitur sipas metodologjisë së re.

Programi financiar për vitin 2026 bazohet në analizën e kostove të programeve dhe shërbimeve shoqëruar me preventivat përkatës në vite dhe në objektivin për rritjen e standarteve dhe cilësisë së tyre, si dhe hartimi i buxhetit të balancuar. Kjo formë detyron formulimin e qartë të prioriteteve në çdo nivel organizativ.

Bashkia Patos për vitin 2026 parashikon të përdorë për të gjitha funksionet **733,839,281** lekë nga **676,666,231** lekë që ka qënë në vitin 2025 me një rritje në masën **57,173,050** lekë, ose **8 %** më shumë.

Shpenzimet e personelit parashikohen në vlerën **384,881,574** lekë , shpenzimet korente parashikohen në vlerën **143,090,386** lekë, shpenzimet për për fond Rezerve dhe Kontigjence parashikohen në vlerën **6,132,000** lekë dhe shpenzimet për Mbrotjen Civile fond emergjence parashikohen në vlerën **3,157,000** lekë.

Tabela e mëposhtme paraqet të Ardhurat sipas çdo burimi, dhe peshën specifike për çdo burim ndaj totalit.

Tabela nr. 3 Të ardhurat sipas burimeve në lekë


BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Nr	Burimet që e përbëjnë buxhetin 2025-2026	Plan Buxheti 2025	Pesha në % sipas Burimeve të të ardhurave	Plan Buxheti 2026 perfundimtar	Pesha në % sipas Burimeve të të ardhurave
1	Transferta e pakushtëzuar (granti)	180,535,490	27%	188,943,382	26%
2	Rritja e nivelit të pagave	47,536,439	7%	59,728,867	8%
3	Transferta pakushtëzuar sektoriale	136,012,302	20%	156,534,432	21%
4	Të ardhurat vendore planifikuar	312,582,000	46%	328,632,600	45%
TOTAL Buxheti Vendor 2025-2026		676,666,231	100	733,839,281	100%

Grafiku nr. 1 Paraqitja grafike e burimeve të të ardhurave të Bashkisë Patos.


Buxheti 2025

- Transferta e pakushtëzuar (granti)
- Transferta pakushtëzuar sektoriale
- Të ardhurat vendore planifikuar



Buxheti 2026

- Transferta e pakushtëzuar (granti)
- Transferta pakushtëzuar sektoriale
- Të ardhurat vendore planifikuar



Parashikimi Financiar për vitin 2026 mbështetet në:

- *Parashikimin e Shpenzimeve*; parashikimi i shpenzimeve bëhet për çdo kategori të shpenzimeve aktuale. Çdo shpenzim parashikohet në bazë të parashikimit të personelit, operimit dhe mirëmbajtjes dhe shpenzime të tjera;
- *Parashikimin e të Ardhurave*; parashikimi i të ardhurave bëhet në të njëjtën mënyrë si parashikimi i shpenzimeve duke ju referuar çdo takse dhe tarifë, të cilat analizohen në hollësi;
- *Treguesit e Buxhetit Total*; paraqesin një gërshetim të të gjitha burimeve të financimit dhe shpenzimeve gjatë një viti buxhetor, duke qënë të balancuara.

Veprimtaria e Bashkisë Patos në fushën e sistemit fiskal vendor funksionon mbështetur në bazën ligjore, si më poshtë:

- Ligjin nr. 139, datë 17.12 2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar
- Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”,
- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 29/2023 date 02.05.2023 “Per Tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar,
- Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”

- Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,
- Ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,
- Ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligjin nr. 157/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar,
- Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.
- Si dhe në V.K.M dhe udhëzime.

Bashkia Patos garanton funksionimin e saj duke përfutur burime financimi kryesisht nga taksat vendore, të miratuara sipas akteve ligjore në fuqi dhe nga taksat dhe tarifatat vendore të miratuara me Vendime të Këshillit Bashkiak, më konkretisht:

STRUKTURA E TAKSAVE VENDORE

I. Taksat Vendore:

1. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme
2. Taksa e fjetjes në hotel
3. Taksa e ndikimit në infrastrukturë
4. Taksa e Tabelës

II. Taksat Kombëtare ose taksa të ndara:

Taksë kombëtare ku një % të caktuar të saj e përfitojnë edhe njësitë e qeverisjes vendore ndryshe quhet taksë ose tatim i ndarë :

1. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve
2. Taksa nga renta minerare
3. Tatimi mbi të ardhurat personale
4. Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë

III. Taksa e përkohshme e tregut.

STRUKTURA E TARIFAVE VENDORE

1. Tarifa e Pastrimit për Familjet
2. Tarifa për Shërbimin Komunitar
3. Tarifa e Pastrimit për Biznesin
4. Tarifa e Gjellbërimit për Biznesin
5. Tarifa e Ndriçimit për Biznesin
6. Tarifa për mjetet e transportit
7. Tarifa për dhënie Leje ushtrim aktiviteti
8. Tarifa për Shërbime Administrative dhe urbanistike
9. Tarifa e Zënies së Hapësirës Publike
10. Tarifa të ndryshme në funksion të Drejtorive dhe Ndërmarrjeve vartëse.
11. Tarifa për dhënie/marrje me qira të pronave të Bashkisë Patos.

Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Vendimit Këshillit Bashkiak, struktura kryesore e ndjekjes dhe arkëtimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është caktuar Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit në Bashkinë Patos, Njësia Administrative Zharrëz, Njësia Administrative Ruzhdie.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Për planifikimin e të ardhurave për vitin 2026 jemi mbështetur në realizimin si 10/mujor të 2025 si dhe në realitetin e sotëm ekonomik me të cilin përballemi çdo ditë , por sigurisht dhe në legjislacionin fiskal në fuqi.

Tabela nr. 4 e realizimit të të ardhurave për vitin 2025

TABELA E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE PËR VITIN 2025 SIPAS BUXHETIT				
	Kategorizimi sipas të ardhurave Të ardhura nga taksat	I pritshmi i vitit 2025	Të realizuara si 10/mujor	% Realizuar
		189,544,000	95,463,890	50%
	Të ardhura nga tarifat	101,578,000	67,506,968	66%
	Te ardhura te tjera	6,310,000	3,512,901	56%
	SHUMA	312,582,000	166,483,759	53%

Nga të dhënat e mësipërme si 10/mujor për vitin 2025 kemi realizuar afërsisht 53 % të planit vjetor.

PARASHIKIMI PËR VITIN 2026

Për vitin 2026 të ardhurat nga taksat e tarifat vendore, janë parashikuar në shumën 328,632,600 lekë, duke e krahasuar me vitin 2025 kemi parashikuar 16,050,600 lekë më shumë.

Parashikimi i të ardhurave me një rritje prej 5 % vjen si rezultat:

- Rritjen e arkëtimit të të ardhurave nga subjektet që ushtrojnë aktivitet privat,
- Uljen e evazionit fiskal duke ulur numrin e debitorëve,
- Normën e inflacionit ,
- Efektet e ndryshimit të politikës në lidhje me disa taksa,
- Efektet e përmirësimeve administrative,
- Përmirësimin e kushteve të biznesit dhe thjeshtimin e procedurave tatimore,
- Përsosja e sistemit informatik në programin e taksave.

Të ndara sipas grupimeve dhe klasifikimeve buxhetore të ardhurat ndahen në:

I Të ardhurat nga taksat

- Të ardhurat nga taksat për vitin 2026 parashikohen të arrijnë në shumën 199,744,000 lekë ose 1,00,000 lekë më shumë duke e krahasuar me vitin 2025.
- Të ardhurat nga taksat vijnë të mbeten burimi kryesor i të ardhurave pasi përbëjnë rreth 64 % të tyre. Ato financojnë jo vetëm shpenzimet kapitale të qytetit por edhe një pjesë të mirë të shërbimeve publike lokale pasi këto të fundit nuk arrijnë të optimizojnë të ardhurat e gjeneruara nga tarifat e shërbimit.

II Të ardhurat nga tarifat

Të ardhurat nga tarifat për vitin 2026 parashikohen në shumën 122,578,600 lekë ose 15,050,000 lekë më shumë se viti 2025.

III Të ardhura nga dhënia me qera e pronës

- Për vitin 2026 të ardhurat nga dhënia me qera e pronës parashikohet në shumën 3,010,000 lekë.

IV Të ardhura të tjera

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Në grupin të ardhura të tjera përfshihen të ardhurat nga gjobat, pagesat për kopshte dhe çerdhe dhe sponsorizimet e ndryshme. Për vitin 2026 parashikojmë të realizojmë 3,300,000 lekë.

Në vijim të këtij materiali po prezantojmë një analizë më të detajuar mbi parashikimin e të ardhurave sipas çdo takse e tarife vendore, duke bërë edhe analizën e realizimit të pritshëm të të ardhurave për vitin 2026.

Të ardhurat nga Taksat për vitin 2026

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Në zbatim të ligjit nr. 122/2020” Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar bëhen këto ndryshime:

“Neni 11 shkalla tatimore”

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).” Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2026 nuk do të parashikohen.

Taksa mbi Ndërtesat

Për parashikimin e të ardhurave nga kjo taksë jemi mbështetur në ligjin nr. 106/2017 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore ” të ndryshuar.

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Nr.132 date 07.03.2018. i ndryshuar.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2026 parashikohen të realizohen në shumën 22,050,000 lekë e cila është e përbërë nga taksa e pasurisë për qëllim banimi dhe veprimtari ekonomike .

a.

b. Ky parashikim mbështetet në:

- të dhënat për taksën e ndërtesës janë marrë nga rregjistri i taksës së ndërtesës.
- realizimin e të ardhurave si 10/mujor të vitit 2025.
- evidentimin e subjekteve ekzistuese, saktësimin e sipërfaqeve.
- mbledhjen e detyrimeve të prapambetura.
- Duke u mbështetur përsa thamë më sipër kemi këtë tabelë të llogaritjes të vlerës vjetore për taksën për m²:
Sipërfaqe e ndërtesës x çmimi për m² sipas Vendimit Këshillit Bashkiak.

Parashikimi i të ardhurave për taksën e ndërtesës për vitin 2026 paraqitet si më poshtë:


Nr.	Emërtimi	Sip/m ²	Niveli i taksës për m ²	Shuma në lekë
I.	Ndërtesa për biznesin	79,446		8,346,032
	Bashkia Patos	61,000	109	6,649,000

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

	Njësia Administrative Zharëz	16,660	92	1,532,720
	Njësia Administrative Ruzhdië	1,786	92	164,312
II	Ndërtesa për popullatën	779,228		11,352,763
	Bashkia Patos	443,571	15	6,653,565
	Njësia Administrative Zharëz	230,357	14	3,224,998
	Njësia Administrative Ruzhdië	105,300	14	1,474,200
	Totali = I+II			19,698,795
III	Debitor për taksën e ndërtesës			2,351,205
	Njësia Administrative Patos			1,582,000
	Njësia Administrative Zharez			684,000
	Njësia Administrative Ruzhdië			85,205
	Totali = I+II+III			22,050,000

Të ardhurat totale nga Taksa e Ndërtesës për vitin 2026 parashikohen 22,050,000 lekë.

Paraqitja grafike e Taksës së Ndërtesës.



Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksa paguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor.

Për parashikimin i të ardhurave nga kjo taksë është zbatuar neni 23 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Toka bujqësore sipas zyrës kadastrës Njësia Administrative Patos

Nr.	Vendndodhje	Sip/ha	Niveli i taksës sipas V.K.B	Shuma /lekë
1	Kat. I	12.08	5600	67,648
2	Kat. II	142.99	4900	700,651
3	Kat. III	187.954	4200	789,407

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

4	Kat. IV	499.279	3600	1,797,404
5	KAT. V	168.012	3000	504,036
6	Kat. VI	172.165	2400	413,196
7	KAT. VII	223.179	1800	401,722
	SHUMA	1405.659		4,674,064

Debitorë deri në 18 muaj = **1,375,516 lekë**

Shuma totale në lekë = **6,049,580 lekë**

Toka bujqësore sipas zyrës kadastrës Njësia Administrative Zharrëz

Nr.	Vendndodhje	Sip/ha	Niveli i taksës sipas V.K.B	Shuma /lekë
1	Kat. I	4.4	5600	24,640
2	Kat. II	497.3	4900	2,436,770
3	Kat. III	1179.7	4200	4,954,740
4	Kat. IV	388.1	3600	1,397,160
5	KAT. V	29.5	3000	88,500
	SHUMA	2090		8,901,810

Nga kjo sipërfaqe përjashtohen:

1. Persona invalid, 260 persona ,norma për frymë 0.3 dylm= $260 \times 3000 \text{ m}^2 = 780,000 \text{ m}^2 = 78 \text{ ha}$.

Veprimet 78 ha x 3600 = **280,800 lekë**.

Shuma = 8,901,810 - 280,800 = 8,621,010 lekë

Debitorë deri në 18 muaj = **2,362,252 lekë**

Shuma totale në lekë = 10,983,262 lekë

Toka bujqësore sipas zyrës kadastrës Njësia Administrative Ruzhdie

Nr.	Vendndodhja	Sip/ha	Niveli i taksës sipas V.K.B	Shuma /lekë
1	Kat. VI	892	2400	2,140,800
2	KAT VII	1200	1800	2,160,000
	TOTALI	2092		4,300,800

Debitorë deri në 18 muaj = **86,358 lekë**


Shuma totale në lekë = **4,387,158 lekë**

Të ardhurat totale nga Taksa e Tokës bujqësore për vitin 2026 parashikohen 21,420,000 lekë.

Paraqitja grafike e Taksës së Tokës Bujqësore.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Fakti vitit 2024
 Realizimi 10/ mujor 2025
 I Pritshmi i vitit 2025
 Parashikimi vitit 2026



Parashikimi për vitin 2026 është bërë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kadastrës në bazë të formularëve që disponon kjo drejtori.

Taksa mbi Truallin jo hapësire publike

Për planifikimin e të ardhurave nga kjo taksë jemi mbështetur në nenin 23/1 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe në ankesin 2.1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror,

në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.


Për vitin 2026 kemi parashikuar të ardhura nga Taksa e Truallit si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Sip/m ²	Niveli i taksës në lekë	Shuma në lekë
1.	Truall për njësinë Administrative Patos	3,108,439		37,286,000
	Biznesi	2,479,867	15	37,198,000
	Komuniteti	628,572	0.14	88,000
2	Truall për njësinë Administrative Zharëz	80,000		1,200,000
	Biznesi	80,000	15	1,200,000
3	Truall për njësinë Administrative Ruzhdie	933	15	14,000

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Biznesi	933	15	14,000
TOTALI			38,500,000

Paraqitja grafike e Taksës mbi Truallin.



Taksa e Rregjistrimit të Mjeteve të përdorura

Mbështetur në ligjin nr. 68/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 27.07.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar.

Në nenin 4, pika 3 ndryshohet si më poshtë:


Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 0.06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo dite vonesë, por jo më shumë se 21 për qind për çdo vit. 25 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo taksa i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore.

Për vitin 2026 kemi parashikuar të ardhura nga Taksa e Rregjistrimit si më poshtë:

Nr.	Njësitë Administrative	Të ardhurat që i takojnë Pushtetit Vendor në lekë
1	Bashkia Patos	15,403,000
2	Njësia Administrative Zharëz	3,627,000
3	Njësia Administrative Ruzhdie	970,000
	Totali	20,000,000

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Paraqitja grafike e Taksës së Rregjistrimit të Mjeteve.



Taksa mbi Ndikimin në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë është bërë nga Drejtoria e Urbanistikës mbështetur në kërkesat që ka për leje ndërtimi si dhe shkresat e ardhura nga ASHK për legalizimet.

Të ardhurat totale nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për vitin 2026 parashikohen 7,000,000 lekë.

Taksa mbi kalimin e të Drejtës së Pronësisë për pasuri të paluajtshme

1. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

2. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Për parashikimin e të ardhurave nga kjo taksë jemi mbështetur në nenin 28 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Të ardhurat totale nga Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për vitin 2026 parashikohen 400,000 lekë.

Taksë e Tabelës

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin tabele identifikimi mbi 2 m², të trapezuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoret për të reklamuar aktivitetin e të tretëve.

Tabele jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën dhe përmasat e tabelës së sinjalistikës.

Tabele që përdoret për qëllime reklamimi të thjeshtë dhe elektronike.


BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Ky parashikim mbështetet në realizimin faktik të vitit 2024 dhe në realizimin si 10/mujor të vitit 2025.

Për vitin 2026 parashikojmë të realizojmë 650,000 lekë e ndarë: Njësia Administrative Patos 490,000 lekë, Njësia Administrative Zharrëz 150,000 lekë dhe Njësia Administrative Ruzhdie 10,000 lekë.

Të ardhurat totale nga Taksa e Tabelës për vitin 2026 parashikohen 650,000 lekë.

Paraqitja grafike e Taksës së Tabelës



Taksa e Tregut

Parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë është bërë duke zbatuar ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar si dhe në Vendimin e Këshillit të Bashkisë.


Nisur nga realizimi e kësaj takse për vitin 2024 si dhe realizimin si 10/ mujor të vitit 2025, për vitin 2026 parashikojmë duke u mbështetur në realizimin mesatar ditor si dhe numrin e tregëtarëve në treg, shumën 1,290,000 lekë, detajuar si më poshtë:

Nr.	Njësitë Administrative	Parashikimi për vitin 2025 në lekë
1.	Bashkia Patos	820,000
2.	Njësia Administrative Zharrëz	470,000
	Totali	1,290,000

Të ardhurat totale nga Taksa e Tregut për vitin 2026 parashikohen 1,290,000 lekë.

Paraqitja grafike e Taksës së Tregut

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028




Taksa e Rentës Minerare

Në zbatim të ligjit nr. 157/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksën kombëtare” të ndryshuar. Taksa e Rentës Minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënie kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare. Në rastin e eksportit të produkteve minerare, renta paguhet në çastin e bërjes së deklaratës së eksportit. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore. Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës, sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Pagesa e rentës minerare bëhet brenda muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Nisur nga akt rakordimet e bëra si 10/ mujor me Degën e Doganës Vlorë si dhe transferimin e fondeve nga dogana dhe nga tatimet , për vitin 2026 parashikojmë të realizojmë 78,434,000 lekë.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Të ardhurat totale nga Taksa e Rentës Minerare për vitin 2026 parashikohen 78,434,000 lekë. Paraqitja grafike e Taksës së Rentës Minerare



Të ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP)

Në zbatim të shkronjës ç, pika 2 e nenit 25 të ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përfitues në masën 2% nga tatimi mbi të ardhurat personale (TAP) që realizojnë në juridiksion të tyre. Është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore që i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mbi ndarjen e tatimit të ardhurave Personale (TAP).

Të ardhurat totale nga Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP) për vitin 2026 parashikohen 10,000,000 lekë.

Të ardhurat nga Tarifat për vitin 2026

Në bazë të nenit 35 pika 5 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore:

- Për shërbimet publike që ato ofrojnë,
 - Për të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore,
 - dhënie e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj,
 - çdo tarifë tjetër të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara me ligj,
- Në këtë grup të ardhurash përfshihen të gjitha të ardhurat me natyrë jo tatimore.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028**Parashikimi i të ardhurave nga tarifat e transporti liçencë dhe çertifikatë mjeti dhe autorizimet.**

Për parashikimin e të ardhurave nga këto tarifa jemi mbështetur në realizimin faktik të vitit 2023, në realizimin si 9-mujor të vitit 2024. Si bazë ligjore kemi parasysh ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportin rrugor”, Udhëzimeve nr. 15 dhe nr. 20 datë 19.07.2007. V.K.M. nr. 970, datë 02.12.2015 i ndryshuar me V.K.M. nr. 344, datë 19.04.2017.

Të ardhurat nga kjo tarifë për vitin 2026 parashikohen si më poshtë:

Nr.	Lloji i taksës ose tarifës	Parashikohet për vitin 2025 në lekë
1	Liçencë dhe çertifikatë mjeti	1,179,000
2	Autorizime për shitje karburanti.	3,000,000
3	Tarifë parkimi	921,000
	TOTALI	5,100,000

Tarifa e Pastrimit për Familjet

Ky shërbim shtrihet në territorin e Bashkisë Patos, Njësinë Administrative Zharrëz, Njësinë Administrative Ruzhdie (vetëm në fshatrat Ruzhdie, Gjinoqarë).

Në zbatim të V.K.B tarifa aplikohet për të gjitha familjet që e përfitojnë këtë shërbim.

Për Tarifën e Pastrimit për Familjet kemi parashikuar të ardhura për vitin 2026 si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Nr Familje	Niveli tarifës	Shuma e parashikuar për vitin 2026 në lekë
1	Bashkia Patos	Familje	10664		25,214,550
	Familje me perberje nga 1 deri ne 2 pjestar	Familje	4,936	3,900	10,625,200
	Familje me më shume se 3 pjestar	Familje	4,937	5,100	14,589,350
	Familje të skemës së ndihmës ekonomike	Familje	26	0	0
	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri	Familje	233	0	0
	Pensionist, në ato raste kur nuk kanë persona të tjere në çertifikatë familjare.	Familje	532	0	0
2	Njësia Administrative Zharrëz		2658		5,483,550
	Familje me përbërje nga 1 deri ne 2 pjestar	Familje	1218	3,900	2,375,100
	Familje me më shumë se 3 pjestar	Familje	1219	5,100	3,108,450
	Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	54	0	0
	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri.	Familje	167	0	0
3	Njësia Administrative Ruzhdie (fshatrat Ruzhdie, Gjinoqarë)		599		390,000
	Familje me kuatë të plotë	Familje	520	1,500	390,000
	Familje të skemës së ndihmës ekonomike	Familje	34	0	0

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri.	Familje	45	0	0
	Shuma totale				31,088,100

- Përfashtimet

Përfashtimet për tarifën e pastrimit në totale për vitin 2026 zënë vlerën 9,842,600 lekë, sipas kategorive ato jepen në tabelen më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Nr Familje	Niveli tarifës	Shuma e parashikuar për vitin 2025 në lekë
1	Bashkia Patos	Familje	791	3900	3,084,900
	Familje të skemës së ndihmës ekonomike	Familje	26	3900	101,400
	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri	Familje	233	3900	908,700
	Pensionist, në ato raste kur nuk kanë persona të tjerë në çertifikatë familjare	Familje	532	3900	2,074,800
2	Njësia Administrative Zharrëz		221	3900	861,900
	Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	54	3900	210,600
	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri.	Familje	167	3900	651,300
3	Njësia Administrative Ruzhdië (fshatrat Ruzhdië, Gjinoqarë)		79	1500	118,500
	Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	34	1500	51,000
	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri.	Familje	45	1500	67,500
	Shuma totale				4,065,300

Tarifa për Shërbimin Komunitar

Ky shërbim shtrihet në territorin e Bashkisë Patos, Njësinë Administrative Zharrëz, Njësinë Administrative Ruzhdië (vetëm në fshatrat Ruzhdië, Gjinoqarë). Në zbatim të V.K.B. tarifa aplikohet për të gjitha familjet që e përfitojnë këtë shërbim.

Për Tarifën e Shërbimit Komunitar kemi parashikuar të ardhura për vitin 2026 si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Nr Familje	Niveli tarifës	Shuma e parashikuar për vitin 2026 në lekë
1	Bashkia Patos	Familje	10664		8,015,500
	Familje me kuatë të plotë	Familje	9871	1500	8,015,500
	Familje të skemës së ndihmës ekonomike	Familje	26	0	0
	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri	Familje	233	0	0
	Pensionist, në ato raste kur nuk kanë persona të tjerë në çertifikatë familjare	Familje	532	0	0
2	Njësia Administrative Zharrëz		2658		1,828,500
	Familje me kuatë të plotë	Familje	2437	1500	1,828,500
	Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	54	0	0
	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri.	Familje	167	0	0
3	Njësia Administrative Ruzhdië		599		208,000

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

(fshatrat Ruzhdie, Gjinoqarë)	Familje	520	800	208,000
Familje me kuatë të plotë	Familje	520	800	208,000
Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	34	0	0
Invalid, tetraplegjik, , të paaftë, verbëri.	Familje	45	0	0

Të ardhurat totale nga Tarifa për Shërbimin Komunitar për vitin 2026 parashikohen 10,052,000 lekë.

- Përfshirjet

Përfshirjet për tarifën e shërbimit komunitar në total për vitin 2026 zënë vlerën 5,035,700 lekë, sipas kategorive ato jepen në tabelen me poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Nr Familje	Niveli tarifës	Shuma e parashikuar për vitin 2025 në lekë
1	Bashkia Patos	Familje	791	1500	1,186,500
	Familje të skemës së ndihmës ekonomike	Familje	26	1500	39,000
	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri	Familje	233	1500	349,500
	Pensionist, në ato raste kur nuk kanë persona të tjere në certifikat familjare	Familje	532	1500	798,000
2	Njësia Administrative Zharrëz		221	1500	331,500
	Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	54	1500	81,000
	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri.	Familje	167	1500	250,500
3	Njësia Administrative Ruzhdie (fshatrat Ruzhdie, Gjinoqarë)		79	800	63,200
	Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	34	800	27,200
	Invalid, tetraplegjik, të paaftë, verbëri.	Familje	45	800	36,000
	Shuma totale				1,581,200

Tarifa e Pastrimit për Biznesin

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkisë tarifa aplikohet për të gjitha subjektet private që ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në territorin e Bashkisë Patos.

Për Tarifën e Pastrimit për Biznesin kemi parashikuar të ardhura për vitin 2026 si më poshtë:


Emërtimi	Parashikimi për vitin 2026 në lekë
Për Bashkinë Patos	13,562,500
Për Njësine Administrative Zharëz	5,625,000
Për Njësine Administrative Ruzhdie	1,080,000
Shuma totale	20,267,500

Debitorë deri në 18 muaj = **1,300,000 lekë.**

Të ardhurat totale nga Tarifa e Pastrimit për vitin 2026 parashikohen 51,355,600 lekë.

Paraqitja grafike e Tarifës së Pastrimit

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028



Tarifë Ndotje Mjedisit


Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Niveli i këtyre tarifave përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe vendoset për individët, personat fizik ose juridik që ushtrojnë aktivitete, efekti i të cilave në mjedis është i qartë.

Pasqyra e parashikimit të ardhurave nga e tarifa e Ndotjes së Mjedisit

Emërtimi	Parashikimi për vitin 2026 në lekë
Për Bashkinë Patos	8,840,000
Për Njësinë Administrative Zharëz	32,263,000
Për Njësinë Administrative Ruzhdie	2,932,000
Shuma totale	44,035,000

Paraqitja grafike e tarifës për Ndotjen e Mjedisit

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028



Tarifë Gjellbërimi & Ndriçimi


I nënshtrohen të gjithë personat fizik e juridik, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Patos dhe Njesisë Administrative Zharëz.

Pasqyra e parashikimit të ardhurave nga e Tarifa e Gjellbërimit dhe Ndriçimit

Emërtimi	Parashikimi
Tarifë Gjellbërimi	
Bashkia Patos për biznesin	1,667,500
Njësia Administrative Zharëz	582,500
Njësia Administrative Ruzhdie	0
SHUMA	2,250,000
Tarifë Ndriçimi	
Bashkia Patos për biznesin	1,667,500
Njësia Administrative Zharëz	582,500
Njësia Administrative Ruzhdie	0
SHUMA	2,250,000

Paraqitja grafike e tarifës Gjellbërimit dhe Ndriçimit

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028



Tarifa e Zënies së Hapësirave Publike

Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim nga individ dhe subjekte për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Për vitin 2026 parashikojmë të ardhura nga kjo tarifë 250,000 lekë.

Tarifa e Mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit

Baza e tarifës së mirëmbajtjes së infrastrukturës ujitjes dhe të kullimit është sipërfaqe toke në dylim, tarifa llogaritet si detyrim vjetor.

Për vitin 2026 parashikojmë të ardhura nga kjo tarifë 2,880,000 lekë.

Tarifat e tjera

Të ardhurat që do të realizohen nga kryerja e këtyre shërbimeve do të jenë sipas tabelës:

Nr.	Emërtimi	në lekë
1	Vertetime Drejtoria e Financës	12,000
2	Vërtetime Drejtoria e Kadastrës	100,000
3	Vërtetime nga Drejtoria e Urbanistikës, planevendosje dhe njoftim punimesh	2,587,000
4	Vërtetime nga arshiva	150,000
5	Qera objekti	1,710,000
6	Qera toke bujqësore Njësia Administrative Ruzhdie	1,300,000
7	Gjoha	500,000
8	Tarifë reklame	507,000
9	Kopsht + çerdhe	2,800,000
10	Të ardhura nga MZSH	300,000
11	Tarifë shërbimi për varrezat publike	750,000
	Shuma totale	10,716,000

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Totali të ardhurave nga burimet e veta nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2026 parashikohen = 328,632,600 lekë.

TRANSFERTAT NGA BUXHETI I SHETIT

Niveli i transfertës së kushtëzuar dhe të pakushtëzuar përcaktohet çdo vit në ligjin e Buxhetit të Shtetit, sipas kritereve përfituese për cdo Bashki.

II.2 TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR

Ashtu sikurse përkufizohet në ligj dhe në udhëzimet e Ministrisë të Financave, transfertat e pakushtëzuar (grantit) është e ardhur e pushtetit vendor, e trashëgueshme, e përfituar nga buxheti i shtetit pa kusht kthimi, për një qëllim të përcaktuar ose jo, që përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e veta dhe të përbashkëta të qeverisjes vendore.

Transferta e pakushtëzuar për vitin buxhetor 2026 është në vlerën 188,943,000 lekë, nga 180,535,490 lekë në vitin 2025, me një rritje në vlerën 8,407,510 lekë, ose 4% më shumë.

Tabela nr. 5 ,000 lekë

	2025	2026
<i>Transferta e pakushtëzuar</i>	180,535	188,943

Grafikisht: Grafiku nr.2



II.3 TRANSFERTA PËR NIVELIN E PAGAVE

Transferta për "Rritjen e Nivelit të Pagave" për vitin buxhetor 2026 është në vlerën 59,729,000 lekë, nga 47,536,439 lekë në vitin 2025, me një rritje në vlerën 12,192,561 lekë.

{Si në tabelën më poshtë}:

Tabela nr. 5 ,000 lekë

	2025	2026
<i>Transferta për rritjen e nivelit të pagave</i>	47,536	59,729

Grafikisht: Grafiku nr.3



II.4 TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE

Ashtu sikurse përkufizohet në ligj dhe në udhëzimet e Ministrit të Financave, transferata e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara nga pushteti Qendror (Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor, Arsimi parashkollor - për stafin mbështetës, Mbrojtja nga zjarri, Rugët Rurale, Ujitja dhe Kullimi, Administrim Pyje) e përfutur nga buxheti i shtetit pa kusht kthimi, do të përdoret për financimin e shpenzimeve për këto funksione.

Transferata specifike për vitin buxhetor 2026 është në vlerën **156,534,000** lekë, nga **136,012,302** lekë në vitin 2025, me një rritje prej 20,521,698 lekë ose 13.1 % duke plotësuar me mirë nevojat për këto funksione të shtuara.

Sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr.6	në ,000 lekë	
	2025	2026
Transferata pakushtëzuar sektoriale	136,012	156,534

Kjo transfertë do të mbulojë këto funksione:

- **Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile**, si funksion shtesë i detyrueshëm. Ky funksion do të mbulohet nga transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe do të përfshijë shpenzimet e personelit dhe shpenzime operative. Gjithashtu për vitin 2026 ky funksion do të vazhdojë të jetë bashkë me funksionin e emergjencave civile, policinë bashkiake dhe së bashku do të bëjnë një programin e sigurisë publike. Për vitin 2026 fondi për këtë funksion është 27,385,297 lekë, me një rritje prej 2,167,449 lekë krahasuar me vitin 2025. Njësia shpenzuese, Bashkia Patos.
- **Rugët Rurale**, si funksion shtesë i detyrueshëm. Sipas përshkrimeve të reja të vendosura në udhëzimet e PBA-së ky funksion i buxhetit do të përmbledhi edhe të gjitha investimet infrastrukturore prandaj e kemi ndarë këtë program në 2 njësi shpenzuese të cilat janë Bashkia dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike kur tek NDSHP kemi vendosur kryesisht fondet që vijnë me transfertën specifike për këtë program. Transferata e pakushtëzuar sektoriale do të përfshijë shpenzimet e personelit, fondin e veçantë. Për vitin 2026 fondi për këtë funksion është 2,371,911 lekë nga transferata specifike me një rritje prej 69,773 lekë, krahasuar me vitin 2025.
Njësia shpenzuese: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
- **Arsimi Bazë**, si funksion i transferuar. Ky funksion do të mbulohet nga transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe do të përfshijë shpenzimet e personelit edukativ. Për vitin 2026

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

fondi për këtë funksion është 89,639,341 lekë fonde nga **transferta specifike**. Rritja nga krahasuar me vitin 2025 e transfertës së pakushtëzuar sektoriale është në vlerën 9,411,917 lekë ose 11 % e cila është një rritje për të kompesuar rritjen e nivelit të pagave në këtë funksion.

Sipas përshkrimeve të reja të vendosura në udhëzimet e PBA-së dhe VKM ky funksion i buxhetit do të mbulohet nga programi Arsimi, Kultura, Sporti, Çështje sociale.

Njësia shpenzuese: Bashkia Patos.

- **Arsimi mesëm**, si funksion shtesë i transferuar. Ky funksion do të mbulohet nga transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe do të përfshijë shpenzimet e personelit ndihmës dhe shpenzime operative. Për vitin 2025 fondi për këtë funksion është 8,845,210 lekë, nga të cilat 4,556,210 janë fonde nga **transferta e pakushtëzuar sektoriale** dhe 4,289,000 lekë janë fonde nga të ardhurat lokale me një rritje nga viti 2024 të transfertës specifike në vlerën 174,958 lekë ose 4 % e cila është një rritje për të kompesuar rritjen e nivelit të pagave në sektorin e Arsimit.

Njësia shpenzuese: Bashkia Patos.

Ujitja dhe Kullimi, si funksion shtesë i transferuar. Ky funksion do të mbulohet nga transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe do të përfshijë shpenzimet e personelit dhe shpenzime operative. Për vitin 2025 fondi sektorial për këtë funksion është 17,295,179 lekë, nga 16,631,045 lekë për vitin 2026 me një rritje prej 4,212,317 lekë rreth 17%. Njësia shpenzuese: Bashkia Patos.

- **Administrim Pyje**, si funksion shtesë i detyrueshëm i transferuar. Ky funksion do të mbulohet nga transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe do të përfshijë shpenzimet e personelit dhe shpenzime operative. Për vitin 2025 fondi për këtë funksion është 3,514,836 lekë nga të cilat 1,213,836 janë fonde nga **e pakushtëzuar sektoriale** dhe 2,301,000 janë fonde nga të ardhurat e veta të Bashkisë me një rritje nga viti 2024 të transfertës sektoriale në vlerën 664,134 lekë ose 4 %.

Njësia shpenzuese: Bashkia Patos.

II.6 TRANSFERTA E KUSHTËZUAR

Transferata e kushtëzuar jepet për financimin e një pjesë të shpenzimeve për funksionet e përbashkëta dhe për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Këto fonde përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë miratuar. Kjo do të thotë që këto janë fonde të ministrive/institucioneve qendrore dhe për transferimin e tyre nga një njësi e qeverisjes vendore në një tjetër, veprohet sipas rregullave të përgjithshme të transferimit të fondeve buxhetore. Në buxhetin e njërive vendore, fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve që nuk janë transferuar ose deleguar, nuk janë të ardhura vendore dhe nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të tyre.

Funksione të deleguara në pushtetin vendor janë:

- **Shërbimi i gjendjes civile** si funksion i deleguar i detyrueshëm. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion do të dërgohen nga Ministria e Brendshme.
- **Për mbrojtjen sociale**, si funksion i deleguar i detyrueshëm. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të respektojnë destinacionin e përcaktuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

- *Transferta e Kushtëzuar për Mbrojtjen civile sipas e cila alokohet sipas peshës specifike të buxhetit ndaj total buxhetit të 61 Bashkive.*
- *Transferta e kushtëzuar për financimin e projekteve të fituara sipas Ministrive të linjës, ku për vitin 2025-2027 Bashkia Patos ka fituar:
Projektin “Rikonstruktion i shkollës “Sotir Capo” dhe ndërtimi i palestrës me vlere 192,662 mije leke , me bashkefinancim 85% MA me vlerë 163,763 mije lekë dhe 15% Burimet tona me vlerë 28,899 mijë lekë. (trajtuar te fishat e projekteve).
Projektin “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet të varfëra dhe të pa favorizuara” me vlrë 13,667 mijë lekë , me bashkefinancim 70% MEKI me vlerë 9,546 mije lekë dhe 30% Burimet tona me vlerë 4,091 mijë lekë. (trajtuar te fishat e projekteve).
Projektin “Blerje e një traktori dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese” me vlerë 12,000 mijë lekë, me financim 100% MM, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. me vlerë 9,546 mije lekë dhe 30% Burimet tona me vlerë 4,091 mijë lekë.*

6. PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2026

Baza ligjore:

- Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar
- Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar.
- Ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” neni 65.

Vendime, udhëzime dhe V.K.B:

- Udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve”
- Udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018 “Për proceduar standarte të përgatitjes së programit të PBA-së”.
- Udhëzimi nr. 8, datë 28.02.2025 nga Ministria e Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”.
- VKB nr. 10, datë 26.02.2025 “Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave për periudhën 2026-2028”
- VKB nr. 14, datë 19.03.2025 “Mbi Miratimin e Tavanëve Përgatitor të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”.
- Udhëzimit i brendshëm nr. 01, datë 02.04.2025 “Për përgatitjen e Buxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028.
- VKB nr. 31, datë 30.06.2025 “Mbi Miratimin e Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”.
- Udhëzimi Plotësues nr. 19 datë 10.07.2025“ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028” nga Ministria e Financave.
- VKB nr. 40, datë 18.07.2025 “Mbi miratimin e Tavanëve Përfundimtare të PBA 2026-2028”.
- Udhëzimit Plotësues i brendshëm datë 22.07.2025“ Për përgatitjen e Buxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028.
- VKB nr. 59, datë 22.09.2025 “Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm të Rishikuar 2026-2028”.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

- Tranferta e pakushtëzuar së përgjithshme dhe sektoriale për vitet 2026-2028 pasqyruar në sistemin e menaxhimit të buxhetit vendor.

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë Patos për vitin 2025 për të gjitha funksionet parashikohen në masën **676,666,231** lekë, duke patur si burim financimi transfertën e pakushtëzuar e vitit në vlerën **180,535,490** lekë, një burim tjetër financiar me emrin “Rritja e nivelit të pagave” për të balancuar rritjen e nivelit të pagave me ndryshimet ligjore të ndodhura në vlerën 47,536,439 lekë, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore **312,582,000** lekë , të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale **136,012,302** lekë.

Shpenzimet e Pritshme të Bashkisë për vitin 2024 parashikohen në vlerën **845,762,777** lekë, duke pësuar rritje nga shtesa e fondeve të trashëguara në masën 224,434,385 lekë , shtesa nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 9,731,030 lekë gjatë vitit 2024 dhe shtesë nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale në vlerën 7,079,880 lekë gjatë vitit 2024.

Tabela nr. 7 Raporti: BV4 - Shpenzimet e NJVQV sipas programeve dhe Klasifikimit Ekonomik

Emërtimi ,kodi progrm			Viti 2026					Pesha specifike per cdo program %
			SHUMA	Shpz. Personeli (600,601)	Shpz. Operative (602,606)	Shpz. Mbrojtje civile,tjera(604, 609)	Investime (Shpenzime Kapitale (230, 231)	
1	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	AA112	107,032,429	78,213,258	28,319,171	0	500,000	15
2	Siguria Publike	AB112	61,073,664	52,457,531	5,459,133	3,157,000	0	8
3	Zhvillimi Ekonomik dhe Rural	AC112	188,314,036	34,800,499	14,928,047	0	138,585,490	26
4	Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale	AD112	170,211,210	131,061,611	33,163,768	0	5,985,831	23
5	Punët Publike	AE112	201,075,942	88,348,675	62,321,267	0	50,406,000	27
6	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	AF112	6,132,000	0		6,132,000		1
Totali			733,839,281	384,881,574	144,191,386	9,289,000	195,477,321	100

Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2026 vijon të ketë në vëmendje:

- Fokusimin e shpenzimeve në sektorët prioritarë si punë publike, infrastrukturë, mirëmbajtje, arsim, shërbime sociale.
- Proçedura buxhetimi të fokusuara tek produkti/rezultati për çdo program.
- Ruajtjen të pandryshueshëm ose ulje të nivelit të shpenzimeve administrative në bazë të normimit të tyre.
- Zbatimin rigoroz të politikave kombëtare për përcaktimin e nivelit të shpenzimeve për paga.
- Planifikimin e investimeve afatgjata dhe prioritare duke sjellë cilësi në rritje në dy drejtime:
 - Vlerësimi e zgjedhjes së projekteve të investimeve duke mbajtur parasysh kërkesat më emergjente dhe të domosdoshme për plotësimin e nevojave të komunitetit sipas PBA 2026-2028, Planit të Përgjithshëm vendor.


BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

- Sigurimit të shpërndarjes me përparësi të investimeve në projekte të rëndësishme të bazuara në vlerësime dhe studime paraprake.
- Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik kanë një shpërndarje sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 8: Planifikimi i buxhetit 2026 sipas klasifikimit ekonomik. Raporti në %, dhe grafiku

ARTIKULLI	PLANI 2026	Raporti në %
I.Shpenzime personeli	384,881,574	52 %
a-paga	329,943,345	
b-sigurime shoqërore +shëndetësore	54,938,229	
II.Shpenzime operative, nga të cilat disa prej tyre:	153,480,386	21%
a-Kuota e Qarkut	500,000	
b-Qiraja e grize	240,000	
c- Kuotë antaresie shoqata Bashkive	300,000	
d-Bashkëfinancim i Qendrës Multifunksional(70% bashkia+30%Mbrojt sociale+ shtese)	4,240,510	
Dh-Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje	120,000	
e-Mirëmbajtje e Rrugëve Bujqësore	1,800,000	
f- Mbrojtja dhe Emergjencat Civile	3,167,000	
g- Zbatime të vendimeve të gjykatave	1,500,000	
gj-Fondi rezervë dhe i kontigjencës	6,132,000	
e- Çertifikimi dhe Inspektim për energjinë elektrike objektet Arsimore, administrative	500,000	
j-Shpenzime për këshillin Bashkiak dhe kryetar fshatrash	9,500,000	
ë-Kuota për Akademin e Njesive Vendore	298,000	
III.Investime	195,477,321	27%
TOTALI (I+II+III)	733,839,281	100.00%

Grafiku nr.3 sipas klasifikimit ekonomik.



BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

VI.1 Shpenzimet kapitale

Bashkia Patos vijon politikat e saj për kryerjen e investimeve mbështetur në planin 3-vjeçar të miratuar me PBA e vitit 2026-2028 nga Këshilli Bashkiak Patos, si dhe në projekt-planin e përgjithshëm vendor.

Ky plan ka në themel të tij kryerjen e investimeve në infrastrukturë në gjithë qytetin duke mbajtur në vëmendje:

- Pritshmërinë e realizimit të shpenzimeve kapitale për vitin 2026,
- Analizën e performancës së kryerjes së investimit,
- Shkallën e ndikimit të pritshëm në zhvillimin ekonomik e social,
- Numrin e përfituesve nga zbatimi i investimeve,
- Shkallen e ndikimit në reduktimin e varfërisë ,
- Më shumë investime në sektorët prioritarë dhe të domosdoshëm për qytetin,
- Kosto për njësi të përcaktuara për investim.

Për vitin 2026 fondi total për financim nga burimet e veta të shpenzime kapitale është në shumën **161,818,000** lekë .

- Raporti midis shpenzimeve personelit + korente dhe atyre kapitale, arrin respektivisht në 76 % me 24% .
- Bashkia Patos vijon me politikat e saj për kryerjen e investimeve.

VI.2 Shpenzimet Korente të tjera

Shpenzimet korente të Bashkisë Patos për vitin 2026 parashikohen në shumën 160,508,606 lekë të cilat përbëjnë rreth 24 % të totalit të shpenzimeve për këtë vit buxhetor.

Shpenzimet korente përbëhen nga:

- Shpenzimet për materiale zyre dhe të përgjithshme,
- Shpenzimet për materiale dhe shërbime speciale,
- Shpenime për shërbime nga të tretë,
- Shpenzime transporti,
- Shpenzime udhëtimi,
- Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme,
- Shpenzime qiramarrje
- Shpenzime të tjera operative si kontribut për shoqatën bashkive etj ,
- Fondi rezervë, Emergjencës, dhe fondi i kontigjencës.

VI.3 Shpenzime për Personelin

Totali i shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore) për të gjitha funksionet Bashkisë Patos për vitin 2026 është parashikuar në shumën 384,881,573 lekë ose 52 % të shpenzimeve totale.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Shpenzimet e personelit dhe nr.punonjesve sipas njësive shpenzuese të Bashkisë Patos paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 9

Nr	Emërtimi	Nr.punonjesve që mbulohet nga të ardhurat	Nr. punonjesve që mbulohet nga trans.Sektoriale	Nr. Gjithsej	Shpenzime personeli
1	Bashkia	136	94	230	280,305,573
2	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	84	7	91	63,575,712
3	Ndërmarrja e Menaxhimit të mbetjesh Pastrimi, Gjelbërimit	59	0	59	41,000,288
	TOTALI	279	101	380	384,881,573

Shpenzimet e personelit dhe nr.punonjesve , përqindja sipas programeve kundrejt totalit të shpenzimeve të personelit, të Bashkisë Patos paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela nr. 9/1

Viti 2026					
Numri programit	Emërtimi Programit	Kodi progrm	nr.punonjesve që mbulon cdo program	Shpenzimet e personelit	Pesha specifike per cdo program %
1	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	AA112	59	78,213,258	20
2	Siguria Publike	AB112	55	52,457,531	14
3	Zhvillimi Ekonomik dhe Rural	AC112	28	34,800,499	9
4	Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale	AD112	114	131,061,611	34
5	Punët Publike	AE112	124	88,348,675	23
6	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	AF112	0	0	0
	Totali		380	384,881,574	100

VI.4 Shpenzimet Operative

Shpenzimet operative për vitin 2026 paraqiten në shumën **144,191,386 lekë**, të cilat krahasuar me vitin 2025 në shumën **143,459,606 lekë**, kanë një rritje 731780 lekë ose 1%. Këto shpenzime përbëjnë 89 % të totalit të shpenzimeve korrente, dhe 20 % të totalit të buxhetit për vitin 2025. Në thelb të planifikimit të shpenzimeve operative vazhdon të jetë racionalizimi i shpenzimeve administrative, duke vënë theksin në funksionet prioritare si dhe në qëllimin e përdorimit të tyre ku qartësisht vërehet se këto shpenzime shkojnë për realizimin e funksioneve kryesore të Bashkisë Patos.

7. PROGRAMET E ZHVILLIMIT TË QYTETIT

PROGRAMET BUXHETORE PËR VITIN 2026

Bashkia Patos në Vitin 2026 është bërë pjesë e metodologjisë së re të buxhetitmit ku nga 17 programe që buxhetohej deri në vitin 2025 tani janë vetëm 6 programe.

I. PROGRAMI PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM, BASHKIA.

Vështrim i përgjithshëm		
Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
AA112	Planifikim, menaxhim dhe administrim	- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin; - Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjesh, zyra të printimit dhe IT etj; - Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë; - Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore; - Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit. - Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj; - Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit; - Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale. - Administrimi i fondeve të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore. - Pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore; - Amortizimi i huave të marra etj. - Njësia shpenzuese Bashkia Patos

Ky program përfshin funksionet “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, “Çeshtjet financiare dhe fiskale” dhe “Marrëdhëniet me komunitetin”.

Qëllimi 1 i Politikës së Programit

- Qeverisje vendore e përgjegjshme dhe administrata e saj transparente

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore,
- Përdorimi sa më eficient, efektivitet dhe ekonomi i burimeve financiare të Bashkisë,
- Promovimi i Bashkisë për qeverisje të hapur dhe transparente ,dokumenta te publikuara,

Objektivi 1.1 i Politikës së Programit

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Pushteti vendor bashkëpunues , nxitës i zhvillimit ekonomik , përdorimi sa më eficient, efektivitet dhe ekonomi i burimeve financiare të Bashkisë

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore,*
- *Përdorimi sa më eficient,efektivitet dhe ekonomi i burimeve financiare të Bashkisë,*
- *Dorëzimi i të gjitha raporteve financiare brenda afateve (%e raporteve të dorzuara brenda afateve)*

Objektivi 1.2 i Politikës së Programit

Realizimi i mbledhjes së të ardhurave sipas parashikimit.

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Realizimi i të ardhurave*

Qëllimi 2 i Politikës së Programit

Promovimi i Bashkisë për qeverisje të hapur dhe transparente

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Promovimi i Bashkisë për qeverisje të hapur dhe transparente dokumenta te publikuara*

Objektivi 2.1 i Politikës së Programit

Promovimi i Bashkisë për qeverisje të hapur dhe transparente

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Promovimi i Bashkisë për qeverisje të hapur dhe transparente dokumenta te publikuara*

Produkti

- *Shërbimi i Stafit të Administrim & Menaxhim*
- *Akte te miratuara nga Këshilli Bashkiak*
- *Mirëmbajtja e Infrastrukturës dhe Funksionimi i Aparatit të Bashkisë*
- *Përbushja e Detyrimeve Gjyqësore*
- *Nëpunës të trajnuar*
- *Transparenca publike*

• Informacion financiar kryesor

Bashkia Patos sipas programeve të miratuara nga Sistemi i Menaxhimit të buxhetit vendor (SMBV) ka shpërndarë tavane buxhetore në 6 programe. Programet kanë të përfshirë funksione dhe aktivitete sipas natyrës dhe klasifikimit ekonomik. Shpenzimet korente dhe kapitale për programin për vitet 2025 dhe 2026 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Shpenzimet	Plani 2025	Plani 2026
Shpenzime Korente	106,359,929	106,532,439
Shpenzime Kapitale	500,000	500,000
TOTALI	106,859,929	107,032,429

Shpenzimet janë parashikuar me një rritje prej 172,500 lekë.

Kjo rritje mbulon rritjen e shpenzimeve të personelit për këtë program, nga zbatimi i VKM për rritje page.

- **Shpenzimet e personelit janë në vlerën 78,213,258 lekë, për fond të vecantë janë në vlerën 894,232 lekë.**
- **Shpenzimet operative për vitin 2026:**

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Këto shpenzime përfshijnë:

- Aparatit të Bashkisë Patos, me drejtoritë dhe sektorët përbërës të saj.
- Aparati i Njesisë Administrative Zharrëz
- Aparati i Njesisë Administrative Rruzhdije

Shpërndarja e shpenzimeve operative sipas klasifikimit ekonomik:

- Materiale zyre dhe të përgjithshme
- Materiale e shërbime speciale
- Shërbime nga të tretë
- Shpenzime transporti
- Shpenzime udhëtimi
- Mirëmbajtje të zakonshme
- Shpenzime të tjera operative

Totali i këtyre shpenzimeve administrative paraqitet në tabelën e mëposhtme:

	PLAN 2026
I Shpenzime Operative	27,424,939
A Materiale zyre dhe të përgjithshme	2,950,000
B Materiale e shërbime speciale	820,000
C Shërbime nga të tretë	7,300,000
D Shpenzime transporti	250,000
E Shpenzime udhëtimi	600,000
F Mirëmbajtje të zakonshme	1,300,000
G Shpenzime të tjera operative	14,204,939

➤ Shpenzimet kapitale për vitin 2026 janë në vlerën 500,000 lekë:

II. PROGRAMI SIGURIA PUBLIKE BASHKIA.

Vështrim i përgjithshëm		
Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vijnë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
AB112	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	• Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vërtetimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj.

Ky program përfshin funksionet “Shërbimet e Policisë Vendore”, “Mbrotja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile” dhe “Emergjencat Civile”. Gjithashtu në këtë program është përfshirë dhe siguria publike për institucionet arsimore dhe publike.

Qëllimi 1 i Politikës së Programit

- *Garantimi i sigurisë publike .*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Patrullime për sigurinë publike*
- *Rritja e mbulimit për garantimin e sigurisë publike.*

Objektivi 1.1 i Politikës së Programit

- *Forcimi i kapaciteteve për parandalimin dhe konstatimin e kundërvajtjeve administrative në të gjithë territorin.*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Rritja e mbulimit për garantimin e sigurisë publike*
- *Rritja e numrit të kundërvajtjeve të identifikuar dhe trajtuara*

Qëllimi 2 i Politikës së Programit

- *Përmirësimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave, ulja e rrezikut nga zjarret dhe fatkeqësitë natyrore, dhe garantimi i sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtjes së mjedisit.*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Përmirësimi i shërbimeve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit*

Objektivi 2.1 i Politikës së Programit

- *Administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve të shërbimeve të mbrojtjes kundër zjarrit, permbytjeve dhe fatkeqësive natyrore dhe ndërhyrjeve për shpëtim.*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Përmirësimi i shërbimeve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit*

Objektivi 2.2 i Politikës së Programit

Siguria e pronës , jetës, gjësë së gjallë.

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Marrja e masave për parandalimin e situatave të rasteve emergjente*

Produkti

- *Shërbime të mbrojtjes civile*
- *Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit*
- *Punonjës zjarrfikës të trajnuar*
- *Familje të dëmshpërblyera për dëme nga fatkeqësitë natyrore*
- *Familje të dëmshpërblyera për dëme nga zjarri*
- *Ndërhyrje Parandaluese dhe Emergjente*

Përshkrimi i Produkteve:

- *Aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e mbrojtjes civile.*
- *Krijimi i gadishmërisë së duhur njerëzore, mjete dhe materiale për t'ju përgjigjur në kohë rasteve të zjarrit dhe shpëtimit në objekte banimi, pyje dhe kullota, aksidente në rrugë, etj, aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me marrjen e masave parandaluese të zjarrit apo*

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

aksidenteve, përfshirë mjete apo materiale të nevojshme si dhe fushata të ndryshme sensibilizuese.

- Zhvillimi i stafit në lidhje me proceset e trajtimit të rasteve të zjarrit dhe shpëtimit përmes trajnimeve apo programeve kualifikuese të zhvilluara nga vetë njësia apo palë të treta (p.sh. MB, projekte të ndryshme, etj.)
- Shpenzimet e parashikuara për dëmshpërblimin e familjeve të cilat preken nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore.
- Shpenzimet nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore për shpërblimin e familjeve të dëmtuara nga zjarri sipas legjislacionit për mbrojtjen civile.
- Aktivitetet dhe Shpenzimet e parashikuara në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore për kryerjen e punimeve të karakterit parandalues dhe emergjent të lidhura me emergjencat civile.

Shpenzimet korente dhe kapitale për programin për vitin 2026 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Shpenzimet korente dhe kapitale për vitin 2026.

Shpenzimet	Plani 2026
<i>Shpenzime Korente</i>	61,073,774
<i>Shpenzime Kapitale</i>	0,000
Total	61,073,774

- Shpenzimet e personelit janë në vlerën 52,457,531 lekë, për fond të vecantë janë në vlerën 1,329,133 lekë ku janë të përfshira shpenzimet për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Mbrojtjen Civile sipas transfertës së pakushtëzuar sektoriale, shpenzimet për Emergjencat Civile të Bashkisë, shpenzimet për Policinë bashkiake dhe për sigurinë publike për institucionet.

Shpenzimet operative për vitin 2026

Shpërndarja e shpenzimeve operative sipas klasifikimit ekonomik:

- Materiale zyre dhe të përgjithshme
- Materiale e shërbime speciale
- Shërbime nga të tretë
- Shpenzime transporti

Totali i këtyre shpenzimeve administrative paraqitet në tabelën e mëposhtme:

	PLAN 2026
I Shpenzime Operative	4,130,000
A Materiale zyre dhe të përgjithshme	50,000
B Materiale e shërbime speciale	760,000
C Shërbime nga të tretë	800,000
D Shpenzime transporti	2,520,000

- Shpenzimet për mbrojtjen Civile për vitin 2026 janë në vlerën 3,157,000 lekë .
- Shpenzimet kapitale për vitin 2026 nuk janë parashikuar.

III. PROGRAMI ZHVILLIMI EKONOMIK DHE RURAL

Ky program përfshin por nuk kufizohet në funksionet e qeverisjes vendore si “Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve”, “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”, “Administrimi i pyjeve dhe kullotave”, Mbrojtja e Mjedisit”, “Rrjeti rrugor rural” Bashkia , “Planifikimi urban vendor”, “Mbështetje e zhvillimit ekonomik”.

- **Shpenzime Totale për këtë program janë si më poshtë:**

Shpenzimet korente dhe kapitale plani për vitin 2026.

	Plani 2026
<i>Shpenzime Korente</i>	49,728,546
<i>Shpenzime Kapitale</i>	138,585,490
Total	188,314,036

- **Shpenzimet e personelit janë në vlerën 34,800,499 lekë, për fond të vecantë janë në vlerën 496,047 lekë .**

- **Shpenzimet operative për vitin 2026**

Shpërndarja e shpenzimeve operative sipas klasifikimit ekonomik:

- Shpenzime transporti
- Mirëmbajtje te zakonshme
- Shpenzime te tjera operative

Totali i këtyre shpenzimeve administrative paraqitet në tabelën e mëposhtme:

	PLAN 2026
Shpenzime Operative	14,432,000
1. Shpenzime transporti	7,228,224
2. Mirëmbajtje te zakonshme	6,640,776
3. Shpenzime te tjera operative	563,000

- **Shpenzimet kapitale për vitin 2026 janë në vlerën 138,585,490 lekë. (sipas fishave të projekteve).**

Përshkrimet dhe pema e programit, funksioneve që përbëjnë programin janë si më poshtë:

✚ **Funkcioni “SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI, SIGURIA USHQIMORE DHE MBROJTJA E KONSUMATORËVE”.**

Vështrim i përgjithshëm		
Mbështetja e zhvillimit të qendrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	• Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave; • Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore; • Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve; • Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë; • Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë; • Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural; • Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit; • Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës.

Qëllimi 1 i Politikës së Programit

- Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj, krijimi projekteve në mbështetje të fermerëve si dhe fuqizimi i përdorimit të qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe kategorive të resurseve të tjera.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Mbështetja e rritjes së prodhimit bujqësor dhe blegtoral

Objektivi 1.1 i Politikës së Programit

- Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës për mbrojtjen dhe administrimin e resurseve natyrore dhe bujqësore, fuqizimi i fermerëve dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore dhe kategorive të tjera në funksion të bujqësisë.

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Zbatimi i politikave dhe projekteve që mbështesin këtë program.

Produkti

- Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor.
- Grante për fermerët

Përshkrimi i Produkteve:

- Aktivitetet dhe kostot përkatëse të lidhura shërbimin e këshillimit dhe ekstensionit bujqësor.
- Shpenzimet për grantet e dhëna fermerëve për zhvillimin e kulturave apo projekteve të ndryshme.

✚ Funkzioni MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Vështrim i përgjithshëm		
Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	• Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla; • Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Ky është një funksion specifik i cili mbulohet nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale.

Qëllimi 2 i Politikës së Programit

- Përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemeve të ujitjes dhe kullimit për bujqësinë, për të garantuar disponueshmërinë e ujit për kultivimin efikas të tokave bujqësore dhe për të mbrojtur tokat nga erozioni dhe përmytjet.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Rritja e sipërfaqes së mbuluar me ujitje dhe kullim

Objektivi i Politikës së Programit

- Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Rritja e sipërfaqes së mbuluar me ujitje dhe kullim

Produkti

- Mirëmbajtja rutinë e kanaleve ujitëse dhe kanale kulluese

Përshkrimi i Produkteve:

- Mirëmbajtja rutinë e **14 Km** lineare kanale ujitës dhe kanale kulluese nëpërmjet pastrimit, sistemeve, mirëmbajtjeve, meremetimeve apo zëvendësimit të torbinove, etj.

Shërbimi i ujitje kullimit realizohet nga Bashkia Patos në bashkëpunim me dy Njësitë Administrative Zharrëz dhe Ruzhdie.

✚ Funkcioni ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Vështrim i përgjithshëm		
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	• Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore; • Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore; • Administrim i fondit pyjor dhe kullosor publik; • Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e licencave për prerje pemësh; • Organizim ose mbështetje për veprimtarinë rryllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë; • Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore; • Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore; • Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes.

Ky është një funksion specifik i cili mbulohet nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale dhe nga të ardhurat e Bashkisë Patos.

Qëllimi 3 i Politikës së Programit

- Bashkia siguron përdorim të qendrueshëm të pyjeve dhe kullotave

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Përmirësimi i shërbimit pyjor dhe kullosor në HA

Objektivi 3.1 i Politikës së Programit

- Racionalizimi dhe mbrojtja e resurseve pyjore

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Zgjerimi i zonave pyjore dhe rritja e efikasitetit të menaxhimit të rezervave pyjore

Produkti

- Shërbimi i Stafit të menaxhimit të fondit Pyjor dhe Kullosor
- Inspektim dhe kontroll i sipërfaqes pyjore/kullosore

Përshkrimi i Produkteve:

- Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e monitorimit dhe mbrojtjes së tokës dhe pyjeve.
- Aktivitetet e inspektimit të të gjitha hapësirave kullosore dhe pyjore për prerje të paligjshme të lëndës drusore duke marrë parasysh hapësirat e shfrytëzuara dhe ato të pashfrytëzueshme

Standardet e Shërbimeve të Programit

- Mirembajtja shtimi i fondit pyjor sipas planit të mbareshtimit.
- Monitorimi dhe ruajtja e fondit pyjor sipas ligjeve në fuqi.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Vështrim i përgjithshëm i Programit “Administrimi i Pyjeve”.

Synimi kryesor i këtij funksioni është përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave. Bashkia Patos ka në pronësi të sajë 682.75 ha pyje Pishë, Lisi dhe Shkurre. Për zbatimin e planit të masave për parandalimin dhe fikjen e zjarreve është planifikuar një fond prej 21.000 lekë në vitë për benzinë për të pastruar anët e rrugëve dhe pyje nga ferra dhe barërat.

1. Për mirëqeverisjen e pyjeve, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorim të qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve në fondin pyjor si pasuri natyrore në pronësi të Bashkis për vitin 2026 kemi parashikuar jashtë tavaneve buxhetor fondin prej 1,600,000 lekë për zërin “Projekti i Planit të Mbarështimit të Pyjeve”. Në mbështetje të nenit 11, 17 të ligjit 57/2020 datë 30/04/2020 dhe VKM nr. 361, datë 12.05.2010 kemi parashikuar hartimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve për sipërfaqen 682.75 ha në Ekonomit Pyjore “Drenie”, “Ana e Lumit Seman 2”, “Krops-Gjorgos”, “Peshtan-Cakran”. Hartimi i Planit të Mbarështimit do të kryhet nga punonjësi me licencë për të bërë menaxhimin sa më të qëndrueshëm për realizimin e projekteve në Sektorin Pyjor të Bashkisë Patos për vitin 2026 e në vazhdim për 10 vjet. Hartimi i planit të menaxhimit ka qënë kërkesë e përsëritur nga Agjencia Kombëtare e pyjeve Tiranë.

Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet përmirësimi i shërbimit pyjor dhe kulloror. Buxheti i alokuar në këtë program do të përdoret nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për pyjet dhe kullotat.

✚ FUNKSIONET “MBROJTJA E MJEDISIT” dhe NDËRGJEGJËSIMI MJEDISOR NJËSIA SHPENZUESE BASHKIA PATOS: 2112001

Vështrim i përgjithshëm		
Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtja ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
05100	Menaxhimi i mbetjeve	• Masa mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja; • Ndërtim, mirëmbajtje dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të ndotjes, si dhe masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. Administrim, mbikëqyrje, inspektim, organizim ose mbështetje e veprimtarive që lidhen me kontrollin dhe zvogëlimin e ndotjes; • Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë që lidhen me uljen dhe kontrollin e ndotjes; • Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.
		• Administrimi, kordinimi dhe monitorimi i politikave, planeve, programeve dhe buxheteve për promovimin e mbrojtjes mjedisore; • Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

		• Identifikim, kontroll dhe menaxhim i burimeve ujore brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore
		•

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Mbrojtja e mjedisit duke rritur cilësinë e jetës së komunitetit dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve.*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Mbrojtja e mjedisit në të gjithë territorin e bashkisë Patos*

Objektivi 5.1 i Politikës së Programit

- *Mbrojtja e mjedisit për një ambient të pastër.*

Treguesit e Performancës për Objektivin

Mbrojtja e mjedisit në të gjithë territorin e bashkisë Patos

Objektivi 5.2 i Politikës së Programit

- *Ndërgjegjësimin mjedisor për të gjithë popullsinë duke e bërë një model jetesën në harmoni me mjedisin.*

Treguesit e Performancës për Objektivin

Ndërgjegjësimin mjedisor për të gjithë popullsinë

Produkti

- *Subjekte të inspektuara*
- *Promovimi i mbrojtjes së mjedisit*

Vështrim i përgjithshëm i Programit.

Për menaxhimin sipas ligjit, të mbetjeve të prodhuara nga familjet Bashkia Patos do të realizojë projekte me në fokus ndërgjegjësimin e banorëve për ndarjen e mbetjeve në burim. Do të realizohen projekte në lagje pilot të Bashkisë Patos dhe në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.

Qëllimi: Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të mbetjeve, reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.

Rezultate:

- Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të Mbetjeve duke përdorur teknologji bashkëkohore.
- Ofrimi i shërbimit cilësor, në kohë dhe në të gjithë territorin.
- Reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.
- Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim.

1. MENAXHIMI I MBETJEVE

Bashkia Patos synon një mjedis të pastër me cilësi të lartë në vazhdimësi, falë punës dhe kontributit të përbashkët të komunitetit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke synuar ndarjen në burim në të gjithë territorin, për një jetesë të shëndetshme. Në mbështetje të ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”, Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit në Bashkinë Patos synon progresin gradual drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Menaxhimi në nivel lokal përfshin zbatimin e skemave të minimizimit të mbetjeve në qytetin e Patosit dhe në shkollat e qytetit për të reduktuar në mënyrë progresive mbetjet për në incinerator. Lidhur me burimet e gjenerimit të mbetjeve , mbetjet bashkiake ndahen në dy rryma mbetjesh, sipas burimit të origjinës:

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

1.MF mbetjet e prodhuara nga familjet

2.MB mbetjet e prodhuara nga bizneset dhe industritë

Për menaxhimin sipas ligjit, të mbetjeve të prodhuara nga familjet Bashkia Patos do të realizojë projekte me në fokus ndërgjegjësimin e banorëve për ndarjen e mbetjeve në burim. Do të realizohen projekte në lagje pilot të Bashkisë Patos dhe në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.

Qëllimi: Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të mbetjeve, reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.

Rezultate:

- Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të Mbetjeve duke përdorur teknologji bashkëkohore.
- Ofrimi i shërbimit cilësor, në kohë dhe në të gjithë territorin.
- Reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.
- Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim.
- Kontribut në Planin e Zhvillimit Vendor lidhur me menaxhimin e mbetjeve.

1. Monitorim i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 26 Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit”, ligjit nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, Ligjit Nr.10 431 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 26 Normat e cilësisë së mjedisit, si edhe Ligjit nr.10 433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Patos do të kryej shërbimin për monitorimin e mjedisit në zonat e ndotura në territorin e Bashkisë Patos kryesisht në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz. Ky monitorim bëhet për të mësuar nivelin e ndotjes dhe për të propozuar masat që duhet të merren për të shmangur ndotjen. Kërkohej që ky monitorim të kryhet nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që disponon operatori. Operatori duhet të jetë i pajisur me certifikatën e laboratorit të specializuar e të akredituar nga Ministria e Mjedisit sipas legjislacionit në fuqi.

2. Mbrojtja e Shëndetit, Shërbimi DDD.

-Në mbështetje të vendimit nr. 369, datë 26.07.1993 “Për Riorganizimin e Shërbimit, të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD), ku thuhet se ky shërbim kalon në vartësi të organeve të pushtetit vendor, si edhe nisur nga detyrat e lëna nga Inspektoriati Shtetëror i Shëndetit për pajisje me Certifikatën e shërbimit (DDD) të institucioneve si shkollat, kopshte dhe çerdhe.

- Shërbimi (DDD) duhet kryer nga persona të trajnuar. Pajisjet dhe materialet të cilat pëdoren për DDD, duhet të jenë të cilësisë së lartë dhe të certifikuara.

Shërbimi do të kryhet në: Shkolla, kopshte dhe çerdhe. Pas kryerjes së shërbimeve DDD bëhet pajisja me certifikatë– dëshmi mbi kryerjen e shërbimeve të caktuara.

Dezinfektimi – bëhet me qëllim të shkatërrimit të mikroorganizmave patogjen, parandalimin e sëmundjeve infektive në ambientet ku punohet.

Dezinfektimi bëhet me preparate përkatese për shkatërrimin e bakterieve gram positive dhe bakterieve gram negative, sporeve, myqeve dhe viruseve.

Dezinsektimi – bëhet me qëllim të mbytjes, largimit dhe pengimin e shumëzimit të Insekteve.

Dezinsektimi bëhet me preparate përkatese që ndikojnë në luftimin e insekteve si :Preparate që shkaktojnë mbytjen e insekteve (insekticide) dhe Preparate që shkaktojnë largimin e insekteve nga hapësira të ndryshme.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Deratizimi – bëhet me qëllim të largimit të minjëve, me qëllim të parandalimit të dëmtimeve që sjellin minjtë (brejtësit).

Deratizimi bëhet me preparate përkatëse “Rodenticide”. Egzistojnë mjete fizike speciale për vendosjen e rodenticideve, këto mjete janë ekologjike dhe të siguruar nga prekja fizike e fëmijëve. Shërbimi DDD për gjithë ambientet e institucioneve si: shkolla, kopshte dhe çerdhe të ndodhura në territorin e Bashkisë Patos.

✦ Funkzioni RRJETI RRUGOR RURAL(INFRASTRUKTURA) BASHKIA.

Vështrim i përgjithshëm		
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04520	Rrjeti rrugor rural	- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore; - Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore; - Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore;

Qëllimi i Politikës së Programit

- Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës . Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe urbane për të siguruar akses të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas për të gjithë përdoruesit, duke përfshirë zhvillimin e rrugëve, urave dhe strukturave të tjera të transportit.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Permiresimi i infrastrukturës

Objektivi 4.1 i Politikës së Programit

- Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane, rurale dhe infrastrukturës . Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Permiresimi i infrastrukturës

Produkti

- Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes Rrjetit Rrugor Rural

Përshkrimi i Produkteve:

- Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Rrugëve Rurale
- Mirëmbajtje rutinë dhe periodike e infrastrukturës rrugore rurale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore; Hartimi i planeve dhe i procedurave të prokurimit për ndërhyrje në mirëmbajtjen e rrugëve; sigurimi i mjeteve dhe bazës materiale për pastrim kanali, mbushjes së gropave me cakull, beton ose asfalt; etj.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

- *Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe lidhja e rrugëve dytësore me ato kryesore dhe nacionale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore; Hartimi i planeve, procedurave të prokurimit dhe zbatimi i ndërhyrjeve në rehabilitimin e rrugëve përmes zëvendësimit të shtresave të asfaltit, shtrimi i shtresave shtesë, pajisja e infrastrukturës rrugore rurale me sinjalistikë horizontale dhe vertikale, etj.*

↓ FUNKSIONI FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME BASHKIA

Vështrim i përgjithshëm		
Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Funksionimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza. Ndërtimi dhe menaxhimi i sistemit të kolektorëve, kanaleve, tubacioneve dhe pompave për të larguar të gjitha ujërat e zeza (ujin e shiut, ujërat shtëpiakë dhe ujëra të tjerë të ndotur).		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
06370	Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	• Administrim i problemeve të furnizimit me ujë; • Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë; • Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë; • Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë; • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë.
		• Administrim, mbikëqyrje, inspektim, vënie në funksionim ose mbështetje e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza; • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza.

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Sigurimi dhe përmirësimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve .*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Permiresim Rrjeti KUZ dhe KUB*

Objekti i Politikës së Programit

- *Funksionimi, përmirësimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe te bardha .*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Permiresim Rrjeti KUZ dhe KUB me fondet e bashkise*

Produkti

- *Zgjerim rrjeti KUZ dhe KUB*

Përshkrimi i Produkteve:

- *Zgjerim rrjeti KUZ dhe KUB ne ml*
- **Shpenzimet kapitale për vitin 2026: 1,000,000 lekë.**

***Funkioni: PLANIFIKIMI URBAN VENDOR.**

Vështrim i përgjithshëm		
Planifikimin dhe zhvillimin i zonave të banimit të përshtatshme në njësinë vendore. Veprimtari për zhvillimin dhe përmirësimin e jetesës.		
Kodii funksionit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
06140	Planifikimi Urban Vendor	• Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të zhvillimit urbanistik; Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të zhvillimit urbanistik; • Planifikim, administrim, zhvillim dhe kontrolli i territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; • Grante, hua ose financime për të mbështetur zgjerimin, përmirësimin ose mirëmbajtjen e stokut të banesave; • Lëshimi i lejeve për ndërtime të reja; zhvillimi i tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore; • Administrim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve të lidhura me strehimin; • Shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e strehimit; • Sigurimi i truallit të nevojshëm për ndërtime banesash; ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njësisë banuese për publikun në përgjithësi ose për njerëz me nevoja të posaçme; eliminim i ndërtimeve të degraduara i lidhur me sigurimin e strehimit; • Planifikim i përgjithshëm duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin, të Planeve të Përgjithshme Vendore /Planeve të Zhvillimit Strategjik; • Hartimi i planeve të zonimit dhe i rregullave të ndërtimit; • Hartim, administrim, bashkërendim dhe monitorim i politikave të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve që lidhen me shërbimet për komunitetin; • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve për zhvillimin e komunitetit; • Planifikimi i komuniteteve të reja ose i komuniteteve të rehabilituara.

Qëllimi 5 i Politikës së Programit

- Planifikim urban për një zhvillim të qëndrueshëm.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Numri i planeve të përgjithshme vendore

Objektivi 5.1 i Politikës së Programit

- Zhvillimi i kapaciteteve për planifikimin urban dhe menaxhimin e zhvillimit territorial.

Produkti

- Projekte të zhvillimit urban të hartuara dhe monitoruara

Përshkrimi i Produkteve:

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

- Hartimi i projekteve të ndryshme nga ana e drejtoria e urbanistikës dhe planifikimit urban; leje për zhvillimin e zonave/njesive të komunitetit (të reja ose rehabilituara); etj.

↓ **Funksioni MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT EKONOMIK.**

Vështrim i përgjithshëm		
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të përgjithshme ekonomike dhe tregtare; Forcimi i zhvillimit ekonomik dhe punësimit vendor. Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi. Zhvillimi i turizmit.		
Kodii funksionit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04130	Mbështetja për zhvillim ekonomik	- Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore; - Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore; - Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe liçensimit të bizneseve; - Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik; - Funksionimi ose mbështetja me politika v endore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë; - Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ; - Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj; - Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj; - Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin. - Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve; - Rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë. - Ndërtim, mirëmbajtje, zgjerim, përmirësim dhe funksionim i strukturave përkatëse me qëllim nxitjen e projekteve me karakter zhvillimor për njësinë vendore; - Hartimi dhe monitorimi i projekteve që kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore; - Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të turizmit vendor; promovim dhe zhvillim i turizmit vendor; - Funksionimi i zyrave turistike vendore, organizim i fushatave publicitare, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaturës promovuese e të një natyre të ngjashme; - Përmirësim i hapësirave pamore urbane të njësisë, përmes mirëmbajtjes së objekteve kulturore dhe turistike që nxisin

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

		rritjen e vizitorëve duke e kthyer në atraksion turistik njësinë vendore.
--	--	---

Qëllimi 6 i Politikës së Programit

- Nxitja dhe mbështetja e zhvillimit ekonomik përmes hartimit dhe zbatimit të politikave efektive që rrisin aktivitetin ekonomik lokal, përmirësojnë infrastrukturën në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Rritja e numrit të bizneseve të reja të regjistruara dhe liçensuara.

Objektivi 6.1 i Politikës së Programit

- Forcimi i politikave dhe infrastrukturës për regjistrimin dhe liçensimin e bizneseve.

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Rritja e numrit të bizneseve të reja të regjistruara dhe liçensuara

Produkti

- Promovimi i Biznesit dhe zhvillimit Ekonomik

Përshkrimi i Produkteve:

- Zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme me qëllim ndihmesën dhe promovimin e biznesit dhe zhvillimit ekonomik.

IV. ARSIMI, KULTURA, SPORTI, ÇËSHTJET SOCIALE

Ky program përfshin por nuk kufizohet funksionet e qeverisjes vendore si “Sport dhe Argëtim”, “Trashëgimia Kulturore, monumentet, muzet dhe bibliotekat”, “Arti dhe Kultura”, “Arsimi Bazë, përfshirë sistemin e arsimit parashkollor”, “Arsimi mesëm i përgjithshëm”, “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, “Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara”, “Strehimi social”.

➤ Shpenzime Totale për këtë program janë si më poshtë:

Shpenzimet korente dhe kapitale plani për vitin 2026.

	Plani 2026
Shpenzime Korente	164,225,379
Shpenzime Kapitale	5,985,831
Total	170,211,210

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

- Shpenzimet e personelit janë në vlerën 131,061,611 lekë, për fond të vecantë janë në vlerën 1,700,768 lekë .

Shpërndarja e shpenzimeve operative sipas klasifikimit ekonomik:

- Materiale zyre dhe të përgjithshme
- Materiale e shërbime speciale
- Shërbime nga të tretë
- Shpenzime transporti
- Mirëmbajtje të zakonshme
- Shpenzime qeramarrje
- Shpenzime të tjera operative

Totali i këtyre shpenzimeve administrative paraqitet në tabelën e mëposhtme:

		PLAN 2026
	Shpenzime Operative	31,463,000
1.	Materiale zyre dhe të përgjithshme	1,045,000
2.	Materiale e shërbime speciale	6,080,000
3.	Shërbime nga të tretë	3,460,000
4.	Shpenzime transporti	962,000
5.	Mirëmbajtje të zakonshme	2,912,000
6.	Shpenzime qeramarrje	240,000
7.	Shpenzime të tjera operative	16,764,000

- Shpenzimet kapitale për vitin 2026 janë në vlerën 5,985,831 lekë.

Përshkrimet dhe pema e programit e funksioneve që përbëjnë programin janë si më poshtë:

✚ Funksioni “SPORT DHE ARGËTIM”.

Vështrim i përgjithshëm		
Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
08130	Sport dhe argëtim	• Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (fusha lojërash, fusha tenisi, pishina noti, korsi vrapimi, ringje boksi, pista patinazhi, palestra etj.); mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtari të sportive; Mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (strukturat për qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojërë me letra, lojërë me tabelë etj.); • Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe apo lojtarë individualë; • Vënie në funksionim ose mbështetje për ambiente që përdoren për veprimtari çlodhëse (parqe, plazhe, kampingje dhe vendqëndrimet përkatëse) të ofruara në bazë jotregtare.

Qëllimi 1 i Politikës së Programit

- Rritja e aksesit dhe cilësisë së strukturave sportive dhe rekreacionale për të nxitur një jetë aktive dhe të shëndetshme për të gjithë qytetarët, duke përfshirë mbështetjen e sporteve dhe aktiviteteve rekreacionale që përforcojnë bashkësinë dhe ofrojnë mundësi për përfshirje sociale.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Rritja e numrit të aktiviteteve sportive dhe argetuese
- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë së fushave ekzistuese sportive dhe rekreacional
- Numri i disiplinave sportive të mbështetura

Objekti i Politikës së Programit

- Bashkia mbështet organizimin e eventeve sportive dhe argetuese. Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës për sport dhe argetim. Promovimi dhe mbështetja e ekipeve dhe sportistëve vendore.

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Rritja e numrit të aktiviteteve sportive dhe argetuese
- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë së fushave ekzistuese sportive dhe rekreacional
- Numri i disiplinave sportive të mbështetura

Produkti

- Shërbimi i stafit të Sportit dhe Argëtimit
- Disiplinat e ndryshme sportive të mbështetura
- Mbështetje për klubin e futbollit

➤ **Vështrim i përgjithshëm i Programit**

Programi për rininë do të ofrojë shërbime specifike në lidhje me a) informimin dhe këshillimin për rininë për shërbimet në shkollë, edukim, për formim profesional, etj, b) vlerësimin e nevojës për mbështetje të rinjve, c) kordinimin e grupeve rinore të shkollave në qytetin e patosit me aktivitet në ambjentet e Stadiumit “Alush Noga” Bashkërendim me sektorin e shërbimeve sociale, shëndetësore e të sportit për nxitjen e aktiviteteve me të rinj.

Pjesa e programit për rininë dhe sportin do të jetë organizimi i përvitshëm i aktivitete sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Këto aktivitete do të zhvillohen sipas traditës që ndiqet për çdo vit nga shkollat e qytetit të Patosit me aktivitete sportive kulturore etj.

Nëpërmjet programit për rininë dhe sportin do të mbështeten administrimi dhe funksionimi i Klubit Shumësportësh “Albpetrol Patos”, si dhe do të mbështeten disiplina të ndryshme.

Pjesë përberëse e programit në mbështetje të sportit të futbollit është mbështetja dhe financimi i ekipeve zinxhire të grupemoshave të ndryshme që janë pjesë e ekipit të futbollit “Albpetrol Patos”. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimin e sportit në komunitet synojmë organizimin e programit “Jeto me Sportin”. Këto aktivitete do të zhvillojnë traditën ku të rinjtë dhe të rejtat e shkollave të Qytetit të Patosit konkurojnë midis shkollave dhe të garojnë mes tyre në mbështetje të Klubit Sportiv “Albpetrol Patos”.

Shpenzimet operative të këtij programi konsistojnë në mbështetjen financiare për funksionimin të klubit sportiv në qytetin e Patosit për të kaluar në Kategorinë e Dytë.

✚ FUNKSIONI TRASHËGIMIA KULTURORE, EVENTET ARSTISTIKE, DHE KULTURORE. FUNKSIONI ARTI DHE KLUTURA

Vështrim i përgjithshëm		
Organizim, mbështetje e ngjarjeve kulturore në njësinë e vetëqeverisjes vendore; mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	• Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrim i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve; • Mbështetja e vendeve historike, kopshteve zoologjike dhe botanike; • Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, e i ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytatar; • Mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e ekspozitave; • Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.); • Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore; • Organizim i aktiviteteve kulturore dhe promovim i identitetit kombëtar e lokal.

Qëllimi 2 i Politikës së Programit

- *Plotësimi i infrastrukturës së objekteve social-kulturore për zhvillimin cilësor të veprimtarive social-kulturore dhe organizimi i veprimtarive artistike-kulturore-sociale me përfshirje në të gjithë territorin e Bashkisë Patos. Promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe artit nëpërmjet përmirësimit të qasjeve dhe ofrimit të shërbimeve edukative, duke rritur ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e komunitetit.*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Numri i shfaqjeve artistike, sociale dhe trashëgimisë kulturore*

Objektivi 2.1 i Politikës së Programit

- *Plotësimi i infrastrukturës së objekteve social-kulturore për zhvillimin cilësor të veprimtarive social-kulturore .*

Objektivi 2.2 i Politikës së Programit

- *Organizimi i veprimtarive artistike-kulturore-sociale me përfshirje në të gjithë territorin e Bashkisë Patos.*

Treguesit e Performancës për Objektivin

Numri i shfaqjeve artistike, sociale dhe trashëgimisë kulturore

Produkti

- *Shërbimet e stafit të trashëgimisë Kulturore, muzeve, bibliotekave*
- *Shërbimet e stafit të Artit dhe Kulturës*
- *Objekte të veprimtarisë kulturore dhe artistike të mirëmbajtura dhe funksionale*

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

- Promovimi i trashëgimisë kulturore

Përshkrimi i Produkteve:

- Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në stafin që mbulon objektet e trashëgimisë kulturore, muzetë dhe bibliotekave të njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Njësitet e vetëqeverisjes vendore planifikojnë shpenzime në këtë produkt për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të objekteve të veprimtarisë kulturore dhe artistike.
- Shpenzimet për broshura, për pika informimi, shfaqje kulturore dhe artistike për promovimin e trashëgimisë kulturore apo forma të tjera për promovimin e trashëgimisë kulturore brenda territorit të njësive të vetëqeverisjes vendore.

➤ **Vështrim i përgjithshëm i Programit**

Programi parashikon mirëmbajtjen e institucioneve kulturore, pajisjen me bazë materiale. Programi gjithashtu do të ndikojë në rritjen e cilësisë së jetës artistike-kulturore të qytetit me projekte të reja, duke i lënë mundësi individëve apo institucioneve kulturore lokale dhe kombëtare të cilat mund të sjellin projekte me vlera kulturore në funksion të argëtimit të komunitetit. Një pjesë e rëndësishme e këtij programi është dhe trashëgimia kulturore e cila do të sjell risi duke promovuar vlerat historike, etnokulturore të gjithë zonës si dhe komuniteteve të ndryshme të Bashkisë Patos.

- Aktivitetet kulturore - sportive e turizmi do të përfshijnë projektet e mëposhtme:

Projekt 1. “Shfaqje teatri”

Projekt 2. “Patosi 'Fest'” .

Projekt 3. “Brez pas brezi myzeqar!”

Projekt 4 “Gjithmonë pranë jush” 1 Tetor

Projekt 5 “Sofra bujare”

Projekt 6 “Ti Shqipëri më jep nder!”

Projekt 7 “Dita e Rinisë” 8 Dhjetori

Projekt 8 “Organizimi i ceremonive zyrtare dhe përkujtimore të datave Historike”

Projekt 9 “Pasurimi i bibliotekës me libra artistik për të rritur dhe aktivitete”

Projekt 10 “Gëzuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri!”

Projekt 11 “Festojmë së bashku”

⬇ **FUNKSIONI ARSIMI BAZË , PËRFSHIRË PARASHKOLLORIN.**

Vështrim i përgjithshëm		
Mbështetja e arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
09120	Arsimi bazë përfshirë parashkollorin	• Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës; • Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve; • Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve; • Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore.

Ky është një funksion specifik i cili mbulohet nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale dhe nga të ardhurat e Bashkisë Patos.

Qëllimi i Politikës së Programit

- Arsim parashkollor dhe bazë për të gjithë dhe përmirësim i infrastrukturës për arritjen e standarteve bashkëkohore.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Mësimi në klasat e arsimit bazë e parashkollor zhvillohet sipas standardit kombëtar nx/kl
- Përmirësimi i infrastrukturës në kopshte/shkolla

Objektivi i Politikës së Programit

- Ndërtim dhe mirëmbajtje e objekteve arsimore bazë dhe parashkollore. Administrimi, inspektimi, organizimi dhe mbështetje për një arsimin të bazë cilësor.

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Mësimi në klasat e arsimit bazë dhe parashkollor zhvillohet sipas standardit kombëtar
- Ndërtesa funksionale të arsimit bazë dhe parashkollor

Objektivi i Politikës së Programit

- Femije që ndjekin kopeshtin.

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Femijë që ndjekin kopshtin

Produkti

- Shërbime mbështetëse të stafit të Arsimit Bazë
- Objekte të arsimit bazë dhe parashkollor të mirëmbajtura dhe funksionale
- Fëmijë që ndjekin kopshtin

➤ **Vështrim i përgjithshëm**

Ky funksion parashikon mirëmbajtjen e institucioneve arsimore parashkollore, pajisjen me bazë materiale si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme higjieno-sanitare, në funksion të rritjes së cilësisë në zhvillimin normal të procesit mësimor-edukativ. Programi mbulon pagesat dhe sigurimet shoqërore të mësuesve në arsimin parashkollor dhe stafit mbështetës. Synon realizimin e administrimit sa më me efektivitet të personelit edukativ për arsimin parashkollor në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, mirëmbajtjen e objekteve, pajisjen me bazë materiale si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme higjieno-sanitare, në funksion të rritjes së cilësisë në zhvillimin normal të procesit mësimor-edukativ parashkollor. Pjesë e rëndësishme e këtij programi është dhe organizimi i veprimtarive argëtuese me fëmijët .

✦ FUNKSIONI ARSIMI MESËM I PËRGJITHSHËM.

Vështrim i përgjithshëm		
Mbështet arsimin e mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur ambientet shkollore dhe pagesën e stafit mbështetës. Programe arsimore dhe trajnim për mësuesit.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	• Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore; • Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale; • Shpenzimet për paga për stafin mbështetës. • Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave; • Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve.
		• Ndërtim dhe mirëmbajtje konviktesh.

Ky është një funksion specifik i cili mbulohet nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale dhe nga të ardhurat e Bashkisë Patos.

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Arsim i mesëm i qëndrueshëm , përmirësim i infrastruktures për arritjen e standarteve bashkëkohore, mbështetje për arsimin e mesëm.*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Shkolla të mesme të mirëmbajtura / rikonstruktura*
- *Përmirësimi i infrastrukturës arsimore në arsimin e mesëm*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Mbështetje për arsimin e mesëm.*

Produkti

- *Sherbime Mbeshtesese të stafit të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm*
- *Objekte te arsimit të mesëm të mirëmbajtura dhe funksionale*

Vështrim i përgjithshëm i funksionit “Arsimi i mesëm”

Ky program parashikon mirëmbajtjen e institucioneve arimore, pajisjen me bazë materiale si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme higjieno-sanitare, në funksion të rritjes së cilësisë në zhvillimin normal të procesit mësimor-edukativ. Programi mbulon pagesat dhe sigurimet shoqërore të personelit ndihmës për sistemin parauniversitar. Synon realizimin e administrimit sa më me efektivitet të personelit ndihmës në funksion të rritjes së cilësisë së higjenës dhe ruajtjes së objekteve shkollore. Pjesë e rëndësishme është nxitja e nxënësve drejt arsimit cilësor dhe motivimi i tyre nëpërmjet stimulimit të ekselentëve.

✦ FUNKSIONET “KUJDESI SOCIAL PËR FAMILJET DHE FËMIJËT” DHE “KUJDESI SOCIAL PËR PERSONAT E SËMURË DHE ME AFTËSI TË KUFIZUARA”

Vështrim i përgjithshëm
Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Dhënia e ndihmës në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të lehtësuar jetën e tyre të përditshme, integrimin në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre. Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Mbulimi i kostove për ofrimin e shërbimit të çerdhes pranë njësive vendore për fëmijët e moshës nga 0 deri në 3 vjeç. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar; marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta

Kodi i programit	Përshkrimi i funksionit	Përshkrimi i funksionit
10430	Përkujdesi social	- Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari; - Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për fatet e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare; - Ndihmë financiare, asistencë për pagesën e një kujdestareje që kujdeset për fëmijët gjatë ditës; - Strehë dhe ushqim dhënë fëmijëve dhe familjeve në mënyrë të përhershme (jetimore, familje kujdestare etj.); - Mallra dhe shërbime dhënë në shtëpi fëmijëve ose atyre që kujdesen për ta; - Shërbime dhe mallrat e ndryshme dhënë familjeve, të rinjve ose fëmijëve (qendra pushimi ose zbavitjeje); - Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore; - Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigjenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktimat të dhunës kriminale etj.); - Përfitime në para, si kompensim page dhe pagesa të tjera për personat e varfër ose të dobët, për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë ose në situata të vështira; - Përfitime në natyrë, si strehë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe vakte ushqimi dhënë personave të varfër dhe të dobët, shërbime dhe mallra për të ndihmuar personat, si këshillim, strehim ditor, ndihmë për të kryer punët e përditshme, ushqim, veshje, lëndë djegëse etj; - Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar; - Përfitime monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.); - Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor; - Përfitime në natyrë, si: vakte ushqimi që u jepen personave të paaftë në ambjente të përshtatshme, ndihmë që u jepet personave të paaftë për t'i ndihmuar në detyrat e përditshme (ndihmë shtëpiake, lehtësi

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

		transporti etj.), pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e paaftë, trajnim profesional e trajnim tjetër i dhënë për të nxitur rehabilitimin në punë dhe atë shoqëror të personave të paaftë, shërbime dhe përfitime të ndryshme dhënë personave të paaftë, për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse ose për të udhëtuar apo për të marrë pjesë në jetën e komunitetit; • Administrim, vënie në funksionim ose mbështetje për skema të mbrojtjes shoqërore.
		• Administrimi dhe mirëmbajtja e qendrave rezidenciale për të moshuarit; • Përfitime në para dhe në shërbime kundrejt rreziqeve të lidhura me moshën e tretë (humbje e të ardhurave, mungesë pavarësie në kryerjen e detyrave të përditshme, pjesëmarrje e ulur në jetën shoqërore dhe komunitare etj.); • Administrim dhe organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore.
		• Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë të aftë për punë, të disponueshëm për punë, por janë të paaftë të gjejnë punësim të përshtatshëm; • Pagesa për grupe pjesë në forcën e punës që marrin pjesë në skemat e trajnimit që kanë për qëllim të zhvillojnë potencialin e tyre për punësim, kompensime për humbje të punës, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të papunët, në veçanti për të papunët afatgjatë; • Përfitime në natyrë, si pagesat për lëvizje dhe zhvendosje; • Trajnim profesional për personat pa punë ose ritrajnim për personat që rrezikojnë të humbin vendin e punës; • Akomodim, ushqim ose veshje dhënë personave të papunë dhe familjeve të tyre;

Qëllimi i Politikës së Programit

- *Të ofrojmë mbështetje, integritet dhe informacion të nevojshëm për të gjitha kategoritë e grupeve vulnerable dhe personave me aftësi të kufizuar.*

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Numri i familjeve që mbështeten me pagese cash nga te ardhurat e bashkise.*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Të ofrojmë mbështetje, integritet dhe informacion të nevojshëm për të gjitha kategoritë e grupeve vulnerable dhe personave me aftësi të kufizuar.*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Numri i familjeve që mbështeten me pagese cash nga te ardhurat e bashkise.*
- *Numri i qendrave multifunksionale të mbështetura*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Fëmijë që ndjekin çerdhen.*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Fëmijë që ndjekin çerdhen.*

Produkti

- *Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social*
- *Persona që përfitojnë kujdesin social*

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

- Shërbimi i Stafit të Kujdesit Social
- Familje dhe individ në nevojë që përfitojnë nga skema e NE
- Femije që frekuentojnë çerdhen.

➤ Vështrim i përgjithshëm i Funksioneve

Ky program parashikon

Mbështetje psiko-sociale e viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Mbështetje financiare për viktimat e dhunës në faamilje dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Mbulim me bashkëfinancim të qendrës multifunksionale. Në vitin 2027 do mbulohet plotësisht nga fondet e bashkisë.

Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar gjatë 2026 janë:

1. Aktivitete sensibilizuese mbi dhunën në familje
2. Transport për viktimat e dhunës
3. Transport për fëmijët në nevojë për mbrojtje
4. Paketa ushqimore për viktimat e dhunës në familje
5. Paketa ushqimore për fëmijët në nevojë për mbrojtje **Mbështetje me pagesë cash (në zbatim të VKM-së nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" për familjet në nevojë socio-ekonomike të cilat nuk janë përfituese të sistemit të ndihmës ekonomike dhe nuk janë të përfshira te fondi 6% nga fondet e MSHMS
6. Pagesë cash për familjet jo përfituese në sistemin e ndihmës ekonomike.

Qendra multifunksionale ofron shërbime psiko sociale dhe terapeutike, terapi zhvillimi, okupacionale veshtirësi në të nxënë. Shërbimi ofrohet me rotacion nga 4 punonjës. Ofrohet dhe fizioterapi sipas nevojës së fëmijës në marrëveshje me fizioterapistin e Qendrës Shëndetësore. Numri i përfituesve aktualisht është 21 të grupmoshes 3 - 21 vjec të diagnozave të ndryshme si çrregullim i spektrit të autizmit, epilepsi, paafësi intelektuale, çrregullime të sjelljes, prapambetje mendore dhe numri pritet të rritet në 25 në vitin 2026 , në 27 në vitin 2027 dhe 30 në vitin 2028.

✚ FUNKSIONI STREHIMI SOCIAL

Vështrim i përgjithshëm		
Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.		
Kodi i programit	Përshkrimi i funksionit	Përshkrimi i aktiviteteve të funksionit
10661	Strehimi social	• Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit; • Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; • Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë; • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit; • Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë;

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

		Përfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira;
--	--	--

Qëllimi i Politikës së Programit

- Rikonstruksioni i banesave me kushte të papërshtatshme për grupet e pafavorizuara dhe trajtim me bonus qeraje.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Numri i banesave të rikonstruara
- Familje që perfitojnë nga bonusi i qerave

Objektivi i Politikës së Programit

- Përmirësimi i jetës i familjeve në nevojë dhe grupet e pafavorizuara.

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Numri i banesave të rikonstruara
- Familje që perfitojnë nga bonusi i qerave.

Produkti

- Familje në nevojë/Individë të subvencionuar për qeranë
- Banesa sociale me qera të mirëmbajtura
- Standardet do ofrohen sipas ligjit 22/2018 “Për strehimin social”.

Aktivitetet kryesore të parashikuara për t’u realizuar gjatë 2026. janë:

- Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit;
- Administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë;
- Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimi

*Rimbursimi i familjeve të pastreha për bonus qiraje në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” me vlerë 600,000 lekë.

V. PROGRAMI PUNËT PUBLIKE

Ky program përfshin por nuk kufizohet në funksionet e qeverisjes vendore si “Menaxhimi i Mbetjeve”, “Shërbimet Publike Vendore”, “Ndriçimi i Rrugëve”, “Transporti Publik”.

➤ Shpenzime Totale për këtë program

Shpenzimet korente dhe kapitale plani për vitin 2026.

	Plani 2026
Shpenzime Korente	150,669,942

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Shpenzime Kapitale	50,406,000
Total	201,075,942

- Shpenzimet e personelit janë në vlerën 88,348,675 lekë, për fond të vecantë janë në vlerën 1,881,911 lekë .

Shpërndarja e shpenzimeve operative sipas klasifikimit ekonomik:

- Materiale zyre dhe të përgjithshme
- Materiale e shërbime speciale
- Shërbime nga të tretë
- Shpenzime transporti
- Mirëmbajtje të zakonshme
- Shpenzime të tjera operative

Totali i këtyre shpenzimeve administrative paraqitet në tabelën e mëposhtme:

	PLAN 2026
Shpenzime Operative	60,439,356
1. Materiale zyre dhe të përgjithshme	167,218
2. Materiale e shërbime speciale	966,661
3. Shërbime nga të tretë	14,869,000
4. Shpenzime transporti	25,805,000
5. Mirëmbajtje të zakonshme	4,179,107
6. Shpenzime të tjera operative	14,452,370

- Shpenzimet kapitale për vitin 2026 janë në vlerën 50,406,000 lekë (sipas fishave të projekteve).

Përshkrimet dhe pema e programit e funksioneve që përbëjnë programin janë si më poshtë:

✚ FUNKSIONI “RRJETI RRUGOR RURAL” NJËSIA SHPENZUESE:N.SH.P.

Vështrim i përgjithshëm		
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04520	Rrjeti rrugor rural	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

		Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësive vendore;
--	--	--

Ky është një funksion specifik i cili mbulohet nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale.

Qëllimi i Politikës së Programit

- Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës . Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe urbane për të siguruar akses të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas për të gjithë përdoruesit, duke përfshirë zhvillimin e rrugëve, urave dhe strukturave të tjera të transportit.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Përmirësimi i infrastrukturës

Objektivi i Politikës së Programit

- Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane, rurale dhe infrastrukturës . Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Përmirësimi i infrastrukturës

Produkti

- Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes Rrjetit Rrugor Rural
- Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur
- Rrjet Rrugor Rural i rehabilituar

Ky funksion në bazë udhëzimit të PBA-së nga Ministria e Financave përfshin edhe të gjitha investimet në infrastrukturë dhe për këtë arsye ne e kemi ndarë këtë program në 2 (dy) njësi shpenzuese , në njësinë shpenzuese Bashkia Patos dhe njësinë shpenzuese Nd. e Shërbimeve Publike ku kemi vendosur kryesisht shpenzimet që janë nga transfertat pakushtëzuar sektoriale për këtë program. Tashmë rrjeti rrugor urban i qytetit lidhet me rrjetin kombëtar rrugor nëpërmjet unazës kryesore dhe unazës rurale të qytetit.

✚ FUNKSIONET SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE , NDRIÇIMI I RRUGËVE . NJËSIA SHPENZUESE: N.SH.P.

Vështrim i përgjithshëm		
Sigurimi i ofrimit të shërbimeve publike vendore		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
06260	Shërbimet publike vendore	- Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; - Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve; - Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore;

Qëllimi i Politikës së Programit

- Përmirësimi i hapësirave publike dhe sistemit të ndriçimit, Shërbim cilësor me standarte dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberuara, parqeve, gjelberim rrugor, trotuare . Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike . Mirëmbajtja e objekteve arsimore dhe administrative.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Rritja e shërbimeve sipas standarteve bashkekohore për komunitetin

Objektivi i Politikës së Programit

- Përmirësimi , shtimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike. Mirëmbajtja e objekteve publike dhe arsimore dhe rregullimi i infrastrukturës publike.

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Përmirësimi i hapësirave publike në 3 njësiti të bashkisë
- Rritja e frekuencës së përdorimit të hapësirave publike nga komuniteti
- Mirëmbajtja e hapësirave publike, objekteve publike dhe arsimore

Objektivi i Politikës së Programit

- Mirëmbajtja e ndriçimit rrugor në 3 njësiti administrative.

Treguesit e Performancës për Objektivin

- Mirëmbajtja e ndriçimit rrugor , efikasitet në konsumin energjisë.

Produkti

- Shërbimi i stafit të ndërmarrjeve publike. Nd.Sh.Publike
- Rrugë urbane e mirëmbajtur dhe rehabilituar
- Trotuare të mirëmbajtur dhe rehabilituar
- Objekte publike të mirëmbajtura
- Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes së Ndriçimit Publik
- Rrjeti i ndriçimit rrugor publik urban dhe rrural i mirëmbajtur
- Rrjeti aktual i ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat rurale të NJVQV; blerja e furnizimit me energji; prokurimi i llambave të ndriçimit, shtyllave të ndriçimit, km kablllo elektrik; etj.

➤ Vështrim i përgjithshëm i funksioneve.

Këto fonde do të shkojnë në realizimin e Qëllimit dhe objektivave të Politikave të Programit në ofrimin e shërbimeve, përmirësimit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore sipas standarteve në të gjitha komponentet e saja të shtrirë në qytet dhe në periferi për t'u mundësuar qytetarve shërbim në kohë, që t'u ofrojmë shërbime në mirëmbajtjen dhe përmirësim të rrugëve, trotuareve, mirëmbajtje e objekteve arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe), riparime, lysterje, merementime të ambienteve jashtë dhe brenda institucioneve, mirëmbajtje e rrjetit hidraulik si dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit rrugor dhe dekorit të qytetit , gjithashtu dhe në mirëmbajtjen dhe shtimin e zonave të reja me ndriçim rrugor.

📌 FUNKSIONI TRANSPORTI PUBLIK N.SH.P.

Vështrim i përgjithshëm

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Sigurimi i ofrimit të shërbimeve të transportit publik në teritorin e pambuluar nga transporti publik privat		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04570	Transporti publik	- Kontraktimi i shoqërive private të transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal; - Mbikëqyrje dhe rregullim i shërbimeve të transportit publik lokal të shoqërive private (miratimi i tarifave për pasagjerët dhe i orëve dhe shpeshtësisë së shërbimeve etj.); - Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, orareve etj. të operacioneve të sistemit publik lokal të transportit; - Grante, hua ose financime për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal.

Qëllimi i Politikës së Programit

Sigurimi i një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm të transportit publik që plotëson nevojat e qytetarëve për lëvizje të lehtë, të sigurt dhe të përballueshme, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe aksesin në transport.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- *Sipërfaqja e Bashkisë e mbuluar me transport publik*

Objektivi i Politikës së Programit

- *Aksesi në transporti publik për të gjithë qytetarët.*

Treguesit e Performancës për Objektivin

- *Sipërfaqja e Bashkisë e mbuluar me transport publik*

Produkti

- *Shërbimi i Transportit Publik*

Përshkrimi i Produkteve:

- *Lëvrime të shërbimeve të transportit publik dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për punonjësit e mirëmbajtjes së transportit publik; investimi dhe mirëmbajtja e mjeteve të transportit publik, vetëm për rrugën patos margëllic; etj..*

📌 FUNKSIONI MENAXHIMI I MBETJEVE

Vështrim i përgjithshëm		
Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtja ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

05100	Menaxhimi i mbetjeve	• Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; • Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; • Pastrimi i rrugëve, parqeve etj. Njesia shpenzuese Bashkia Patos, Ndërrmarrja e menaxhimit të mbetjeve/Pastrimit/Gjelbërimit/varreza
-------	----------------------	--

Ky funksion mbulohet nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale në vlerën 11,900,000 lekë, dhe pjesa tjetër nga burimet e veta.

Qëllimi i Politikës së Programit

- Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane. Sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të efektshëm të menaxhimit të mbetjeve dhe mbajtja e një ambjenti të pastër.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

- Përmirësimi i shërbimeve të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve

Objektivi i Politikës së Programit

- Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit.

Treguesit e Performancës për Objektivin

Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit.

Produkti

- Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane dhe rrurale
- Pastrimi i rrugëve dhe parqeve
- Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve

Vështrim i përgjithshëm i funksionit.

Këto fonde do të shkojnë në realizimin e Qëllimit dhe Objektivave të Politikave të Programit me moton “Për një qytet të pastër” duke venë në efikasitet të plot Asetet e burimeve njerezore, 4 mjetet e transportit dhe burimet financiare për ofrimin e shërbimeve me cilësi sipas standarteve bashkëkohore, në mbledhjen e mbetjeve urbane organike në tre njësi administrative, nga kontineret dhe pikat fikse duke siguruar një ambjent të pastër dhe pa ndotje, në shtrirjen e shërbimeve publike me mbledhjen e mbetjeve urbane në zonat periferike dhe informale, në mbajtjen pastër të rrugëve kryesore, dytesore të 108.000 m² rrugë, shesheve të pallateve, kopshtet, çerdhet dhe institucionet e tjera.

VI. PROGRAMI FONDI REZERVË DHE KONTIGJENCË

Vështrim i përgjithshëm		
“Fond rezervë” është fondi, që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

04910	Fondi Rezervë	“Fond rezervë” është fondi, që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit. Njesia shpenzuese Bashkia Patos
-------	---------------	--

Fondi rezervë është hapur si program në vitin 2025 sipas udhëzimeve të fundit.

Në buxhetin e vitit 2026, Fondi rezervë, nga burimet e veta të llogaritur sipas ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, është parashikuar në shumën 3.066,000 lekë , **dhe përbënë afërsisht 1 % të totalit të buxhetit.**

Fondi Rezervë do të përdoret: Qëllimi i Politikës së Programit

- Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit.
- Përdorimi i tij bëhet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi

Minimizimi i riskut mbi zbatimin e buxhetit

Objektivi i Politikës së Programit, Produkti

Produkti

Fondi rezervë

Përshkrimi i Produkteve:

Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Përdorimi i tij bëhet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

FONDI KONTIGJENCË

Vështrim i përgjithshëm		
“Fond rezervë” është fondi, që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04940	Fondi Kontigjencë	“Fond kontingjence” është fondi i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit. Njesia shpenzuese Bashkia Patos

Fondi kontigjencës është hapur si program në vitin 2025 sipas udhëzimeve të fundit. Në buxhetin e vitit 2026, Fondi kontigjencës, nga burimet e veta të llogaritur sipas ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, është parashikuar në shumën 3.066,000 lekë **dhe përbënë afërsisht 1 % të totalit të buxhetit.**

Qëllimi i Politikës së Programit

Fondi i kontingjencës përdoret sipas përcaktimit në vendimin për buxhetin vjetor të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese.

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi dhe Objektivi

Minimizimi i risqeve , përballimi rasteve .

Produkti

Fondi kontigjencë.

Përshkrimi i Produkteve:

Fondi i kontingjencës përdoret sipas përcaktimit në vendimin për buxhetin vjetor të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese.

Detyrime të Prapambetura

Është fakt pozitiv për Bashkinë Patos që për disa vite rreshtë për Detyrimet e prapambetura nuk ekzistojnë, janë 0 lekë.

Rreziqet financiare dhe fiskale. Vlerësimi i rreziqeve financiare e fiskale dhe masat për zvogëlimin e rrezikut.

Analiza dhe trajtimi i rreziqeve është puna më domethënëse dhe më frytdhënëse gjatë hartimit të dokumenteve bazë të funksionimit të një institucioni (Rregullorja e brendshme, plani i zhvillimit strategjik, programi buxhetor afatmesëm, etj), si dhe më tej gjatë zbatimit dhe monitorimit të tyre. Menaxhimi i këtyre rreziqeve në vetvete do të thotë të identifikosh, vlerësosh dhe kontrollosh ato situata të cilat ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të drejtorive. Kur themi “Objektiva”, konkretisht i referohemi objektivave afatmesme të cilat përkthehen deri në plane vjetore operacionale të drejtorive të Bashkisë. Pra, menaxhimi me fokus në rrezik është instrumenti kryesor që çon në arritjen e objektivave vjetore dhe më tej të Buxhetit të Vitit dhe të PBA-së.

Bashkia Patos si çdo institucion tjetër i qeverisjes vendore dhe qendrore ka një sistem të vendosur të Menaxhimit dhe Kontrollit, të cilin përpiqet vazhdimisht për ta përmirësuar në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi. Treguesit e performancës së buxhetit dhe menaxhimi i riskut mbeten fushat më të vështira brenda kornizës së kontrollit të brendshëm për Bashkinë. Kjo do të thotë që vëmendja kryesore e çdo hallke drejtimi dhe çdo funksion kontrolli duhet të fokusohet në menaxhimin e punës dhe kërkesën e llogarisë mbi bazën e risqeve të identifikuar më parë, dhe mbi të gjitha në parashikimin realist të të ardhurave të bashkisë, përdorimin me efektivitet të fondeve vendore dhe menaxhim sa më të mirë të situatave financiare, për të minimizuar rrisqet e identifikuar në cdo drejtori për realizimin e të gjitha aktiviteteve të programeve.

- Buxhetimi Gjinnor, Sfidat dhe Vëmendja

Në buxhetim është marrë parasysh një buxhetim i përgjegjshëm gjinnor i të pasurit një strategji që mundohet të matë ndikimin e politikave të bashkisë mbi gratë dhe burrat duke i balancuar dhe shpërndarë të ardhurat në mënyrë të tillë që shërbimet të shkojnë njëlloj të përfituara si nga burrat dhe gratë.

Një buxhetim i përgjegjshëm gjinnor do të thotë të analizosh buxhetet vendore, duke i vlerësuar sa i përgjigjen ato nevojave të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave, si dhe nëse ato kontribuojnë apo jo për rritjen e barazisë midis grave dhe burrave.

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

Një buxhet i balancuar gjinor nënkupton ofrimin e mundësive njësoj të aksesueshme si për meshkujt dhe për femrat duke mundësuar kështu zvogëlimin sa më shumë të pabarazisë gjinore.

Vlen të theksohet se në Bashkinë Patos së fundmi përpos faktit që mundësia e punësimit është ofruar njësoj për të dyja gjinitë ka një trend rritës të punësimit të punonjësve femra edhe në pozicione drejtuese madje vlen të përmendet mënyra shumë efektive e realizimit të këtyre proceseve të punës.

Normalisht për të hartuar një buxhet me qasje gjinore ka dhe sfidat e tij, dhe kjo në kuptimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore gjinore duke specifikuar kështu përfituesit e një funksioni të caktuar buxhetor. Një projekt i hartuar dhe më pas i vënë në zbatim në një zone të caktuar paraprakisht duhet të jetë i mirëstudiuar se cilët janë përfituesit e tij, sa i vjen në ndihmë dhe sa dobi sjell për ta.

Një tjetër hap i ndërmarrë në promovimin dhe mbështetjen e buxhetimit gjinor është organizimi i aktiviteteve të ndryshme me fokus rritjen e vetëbesimit tek femrat madje edhe në ato raste ku fatkeqësisht hasen femra të dhunuara apo të nënshtruara. Kjo kategori është mbështetur shumë nga Sektori i Shërbimit Social, ku është ngritur një qendër për punime artizanale për motivimin dhe rritjen e vetëbesimit të tyre. Nëse besojnë në veten e tyre ato mund të jenë motorri i zhvillimit të shoqërisë.

Në Buxhetin e Bashkisë Patos, brenda zërit të shpenzimeve operative përfshihet fondi prej 100,000 lekë për mbështetjen dhe shtysën e projekteve që synojnë përfshirjen e grave në procesin e vendimmarrjes.

Lista e projekteve të investimeve kapitale, prioritare:

LISTA E RRUGEVE PRIORITARE PER INVESTIME

Nr	Emertimi i Objektit
1	Rikonstruksion i Ruges Colet
2	Rikonstruksion i Ruges Argjinatura-Belinë
3	Rikonstruksion i Ruges Kocaqet-Sheqishte
4	Rikonstruksion i Ruges Pepajt-Frashër
5	Rikonstruksion i Segmentit të rruges Fitore-Frashër
6	Rikonstruksion i Ruges Hoxhaj-Verbas
7	Rikonstruksion i Ruges Blloku i pemeve-Verbas
8	Rikonstruksion i Ruges Kompleksi Blektoral-Verbas
9	Rikonstruksion i Ruges Shortet-Verbas
10	Rikonstruksion i Ruges Griza-Verbas
11	Rikonstruksion i Ruges Jashar Cakrani-Verbas
12	Rikonstruksion i Segmentit të rruges Serat-Fshat i Ri
13	Rikonstruksion i Segmentit të rruges Fitorja-Fshat i Ri
14	Rikonstruksion i Ruges Albetrol Nacionale-Fshat i Ri
15	Rikonstruksion i Ruges Halit Gjiriti-Zharrez
16	Rikonstruksion i Ruges Shollaj-Zharrez

BUXHETI 2026 DHE PBA 2026-2028

17	Rikonstruksion i Rruges Diellaj-Zharrez
18	Rikonstruksion i Rruges Bracallaret-Zharrez
19	Rikonstruksion i Rruges Hajdinaj-Zharrez
20	Rikonstruksion i Rruges Qender-Zharrez
21	Rikonstruksion i Rruges Cobanet-Zharrez
22	Rikonstruksion i Rruges Gjerbacaku-Zharrez
23	Rikonstruksion i Rruges Belulaj-Zharrez
24	Rikonstruksion i Segmentit te Rruges Zabia-Zharrez
25	Rikonstruksion i Rruges Muharrem Agolli (Nc)-Zharrez
26	Rikonstruksion i segmentit te rruges Rilindja-Belinë
27	Rikonstruksion i Rruges Naim Frasheri afer Kripallareve
28	Rikonstruksion i Rruges e Beharajve
29	Rikonstruksion i Rugës Oficina
30	Rikonstruksion i rrugeve te Lgj. Shkëmbit
31	Rikonstruksion i Rugës Kalasë
32	Rikonstruksion i Rruges Patos- Mustafa Matohiti
33	Rikonstruksion i Rruges Manxhari-Gjinoqare
34	Rikonstruksion i segmentit te rrugës Shperdhese së bashku me rruget e brendshme të fshatit Banaj
35	Rikonstruksion i rrugës Buzaj-Rerës
36	Rikonstruksion i rrugëve të brendshme, Margëllic
37	Rruga Saliaj- Grize
38	Vazhdimi i rrugës Fontana

LISTA E OBJEKTEVE PRIORITARE PER INVESTIME

Nr	Emertimi i Objektit
1	Rikonstruksion i Shkolles Hekuran Maneku
2	Rikonstruksion i Pallatit Kultures
3	Rikonstruksion i Stacionit te policise, Patos
4	Krijimi i Parkut rekreativ ne lagjen e Re
5	Rikonstruksion i Klubi i Pencionisteve
6	Rikonstruksion i aneksit te stadiumit Patos
7	Rikonstruksion i Shkolles Sadush Dervishi-Ruzhdie
8	Adaptimi i ish-Komitetit ne muze per qytetin
9	Rehabilitimi i perroit Zharrez
10	Rikonstruksion i shkolles Sotir Kola-Beline
11	Rikonstruksion i kopeshtit Lagjja e Re
12	Rehabilitimi i perroit Dukas
13	Rikonstruksion i stadiumit Alush Noga
14	Krijimi i nje sistemi vaditje ne Nj. A. Zharrez
15	Ndertim i rrjetit KUZ ne Grize Lenginas dhe Lagjen 29 Marsi

Nëpunësi Zbatues
Dr. Finance
Mimoza Shtëmbari

Koordinatori i GMS
Zëvendëskryetare
Ina Sauli

Nëpunësi Autorizues
Kryetari
Fation Duro

BASHKIA PATOS

